

David Graham

Si u be
Greqia
europiane?



BIZNESI

Mesymja e
madhe drejt
Kubes



BRZHEZHINSKI

Ne jemi tashme
ne Luftë
te Ftohte

Politika

Botim elektronik i ASP ne bashkepunim me Bota.al-Korrik 2015

A dështoi Merkeli me Greqinë dhe Europen?

Analiza e Der Spiegel





Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

bota.al

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lekët në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

botimeshqip.com
Libri Shqip në shqipëri tani!

Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



Një prej “dënimeve” që merr kur refuzon të marrësh pjesë në politikë, është se përfundon duke u qeverisur nga ata që janë inferiorë ndaj teje.

Platoni

Vendi më i nxehtë në Ferr u është rezervuar atyre që qëndrojnë neutralë, në kohëra konflikti të madh moral.

Martin Luther King Jr.

Politika është luftë pa gjakderdhje, ndërkohë që lufta është politikë me gjakderdhje.

Mao Cedun

Njeriu është nga natyra një kafshë politike.

Aristoteli

Nëntëdhjetë përqind e politikanëve i japin dhjetë përqindëshit tjetër një reputacion të keq.

Henry A. Kissinger



Brzhezinski: Ne ndodhemi tashmë në një Luftë të Ftohtë

NGA SEBASTIAN FISCHER DHE HOLGER STARK

Ish-këshilltari i Këshillit të Sigurisë Kombëtare në SHBA, Zbigniew Brzhezinski, beson se Perëndimi duhet t'u qëndrojë fort aksioneve të presidentit rus Vladimir Putin në Ukrainë. "Ne duhet ta bëjmë më të kushtueshme përdorimin e forcës nga rusët",- thotë ai gjatë një interviste për "Der Spiegel". Rusia dëshiron të zgjerojë arsenalin e saj të raketave ndërkontinentale. SHBA-ja nga ana e saj, synon të instalojë armatimin e rëndë në vendet e Evropës

Lindore, anëtare të NATO-s. Përveç kësaj, Uashingtoni po shqyrton mundësinë e vendosjes në Evropë të raketave të reja atomike, në kundërpërgjigje të pretendimeve se Moska ka shkelur traktatin e pakësimit të armëve.

Kriza në Ukrainë po kërcënon të përhapet. Zbigniew Brzhezinski, që ka mbajtur detyrën e këshilltarit të sigurisë kombëtare i presidentit Xhimi Karter në vitet 1977-1981, flet për Luftën e re të Ftohtë. Aktualisht 87-vjeç, ai punon për Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS) në Uashington.

Spiegel: Zoti Brzhezinski, a po përjetojmë fillimin e një Luftë të re të Ftohtë, midis Rusisë dhe SHBA-së?

Ne jemi tashmë në një Luftë të Ftohtë. Nëse kjo do të bëhet e nxehtë, për fat të mirë ka ende pak gjasa.

Spiegel: Lufta e fundit e Ftohtë zgjati më shumë se 40 vjet. A do të zgjasë po aq këtë herë?

Nuk e besoj. Gjërat lëvizin shumë më shpejt. Presionet nga jashtë, sot ndihen më shumë së brendshmi. Nëse kjo situatë vazhdon, dhe nëse Ukraina nuk do të shembet, presionet e brendshme në Rusi do të detyrojnë cilindo që është në pushtet, të shqyrtojë alternativat e tjera. Unë shpresoj se Putin është i zgjuar sa ta dijë, se është më mirë të shqyrtojë skenare të tjerë para kohe, dhe jo kur të jetë shumë vonë.

Spiegel: A është ai mjaftueshëm i zgjuar?

Kjo është shumë e vështirë për t'u përcaktuar. Ai ka atë që quhet "smarts" në SHBA, një lloj zgjuarsie instiktive. Ai ka një sofistikim të vërtetë. Unë pyes veten pse Putin thajse qëllimisht po armiqësohet me më shumë se 40 milionë njerëz të një vendi fqinj, që deri kohët e fundit nuk kishte ndonjë armiqësi ndaj Ruisë.

Spiegel: Mendoni se është e drejtë për SHBA-në, të dërgojë armë të rënda në Evropën Lindore dhe shtetet balltike?

Por ju a mendoni se është e drejtë të dërgohen trupa dhe armë në një vend sovran dhe të fillohet një luftë e kufizuar, pasi të kesh pushtuar një pjesë të madhe të tij?

Spiegel: Ju jeni duke folur për veprimet e Ruisë në Ukrainë...

Ju duhet të shihni të dyja anët e medaljes. Kjo është një çështje e veprimit dhe reagimit. Unë nuk dua luftë, por nuk do të frikësohem nga argument, se nëse ne i kundërpërgjigjemi në mënyrë simetrike veprimeve të njëanshme të palës tjetër, atëherë i bie të jemi disi provokues dhe shkaktarë të luftës. Është në fakt e kundërta. Të mos veprosh në këtë mënyrë, do të thotë të rrisësh shanset për të shkaktuar një luftë.

Spiegel: Por a nuk është NATO duke luajtur sipas propagandës anti-perëndimore të Putinit?

Ju doni të thoni se NATO-s, nuk i lejohet të vendosë trupa në territorin e shteteve të saj anëtare, kur diçka potencialisht e rrezikshme po ndodh aty pranë?

Spiegel: Çështja është politikisht e mençur, për shkak mbështetjes në rritje që ai mund të sigurojë në vend...

Ky është pikërisht argumenti, që dikush mund të ketë bërë për një reagim si ai për të përmbajtur Gjermaninë Naziste, kur Hitleri pushtoi Sudentet në Çekosllovakia ose me Anshlusin në Austri.

Spiegel: Jeni duke e krahasuar Putinin me Hitlerin?

Unë mendoj se ka disa ngjashmëri, por edhe dallime. Hitleri nuk ishte i interesuar në mënyrë të veçantë, për të bërë sa më shumë para. Putin ka një interes anësor në krijimin e një pasurie të madhe, dhe kjo paraqet një perspektivë disi të ndryshme në jetën e tij, e cila ndoshta mund të stabilizojë dhe kalitë pasionet. Por ajo që mbetet veçanërisht e rrezikshme, fakti që ai është një lojtar.

Spiegel: Le të imagjinojmë një skenar ku Rusia pushton vendet baltike. A do të bëhet NATO pjesë e luftës?

Natyrisht, nëse Putin e ndërmerret këtë hap. Kjo është edhe në statutin e NATO-s, apo jo? Ne s'mund t'i themi botës: "Ne nuk e kemi me gjithë mend atë që themi. Ne nuk do të bëjmë asgjë, nëse ju bëni ndonjë gjë?" Kjo është pak e shumë si të varësh në derën e përparme shënimit: "Ne jemi larguar, dyert nuk janë mbyllur". A mendoni se kjo do të ishte një strategji e zgjuar mbi sigurinë?

Spiegel: Sipas një studimi të kohëve të fundit nga "Pew Research Center",

58 përqind e gjermanëve nuk beson se Gjermania duhet të përdorë forcën ushtarake për të mbrojtur një aleat të NATO-s, nëse sulmohet nga Rusia. E kam lexuar atë anketë. Atëherë unë pyes:sa gjermanë do të shpreheshin kështu, nëse Gjermania sulmohet, a nuk duhet që Shtetet e Bashkuara t'i shkojnë në ndihmë?

Spiegel: Ndoshta, shumica do të thonë se Shtetet e Bashkuara duhet të na ndihmojnë...

Po, natyrisht. Kjo është natyra e njeriut. Kjo është arsyeja, pse unë nuk shqetësohem shumë për këto gjëra, sepse natyra e njeriut ndryshon me ndryshimin e rrethanave. Shikoni lituanezët, atij vendi shumë të vogël. Ata kanë bërë me dije, se do të marrin të gjitha masat për të mbrojtur veten. Dhe kjo duhet ta bëjë me turp Gjermaninë. Në fakt, unë besoj se Gjermania do të luftonte. Unë mendoj se zonja Merkel do të luftonte. Dhe opozita do të bënte të njëjtën gjë.

Spiegel: Në konfliktin ukrainas, presidenti amerikan Obama e ka lënë kancelaren gjermane Merkel të marrë rolin e udhëheqëses. Është një lëvizje e mirë?

Unë besoj se kancelarja Merkel, është duke bërë një punë jashtëzakonisht të mirë. Obama ndërkohë ka disa probleme të tjera, siç është për shembull Lindja e Mesme.

Spiegel: Merkel beson se dërgimi i armëve në Ukrainë, do të ishte një hap i gabuar. Ajo nuk beson se ka një zgjidhje ushtarake të krizës. Cili është komenti juaj?

Ne duhet ta bëjmë sa më të kushtueshme përdorimin e forcës nga rusët. Unë mendoj se ka kuptim, që Ukraina të furnizohet me armë mbrojtëse, si mortaja dhe raketa anti-tank, me qëllim mbrojtjen e qyteteve të mëdha. Nëse doni të menaxhoni një vend të madh, duhet të merrnin nën kontroll qytetet e mëdha. Duke e bërë këtë, kjo ka një kosto aq të lartë, sa njerëzit janë të gatshëm për ta mbrojtur.

Spiegel: A shihni një zgjidhje të mundshme të krizës, që ia del të shmangë përshkallëzimin e mëtejshëm të situatës?

Unë besoj se rezultati përfundimtar i kësaj krize, duhet të arrihet në bazë të një përshatjeje, dhe se korniza themelore për një gjë të tillë, është firmosja nga ana e Ukrainës të të njëjtave marrëveshjeve, që kanë garantuar me herë stabilitet dhe paqe për disa dekadave me rradhë, ndërmjet Ruisë dhe Finlandës. Ukraina, duhet lënë e lirë të zgjedhë identitetin dhe filozofinë e saj politike, dhe ta institucionalizojë atë përmes lidhjeve më të ngushta me Evropën. Por në të njëjtën kohë, Rusia duhet të sigurohet në mënyrë të besueshme, se Ukraina nuk do të bëhet anëtare e NATO-s. Unë ende mendoj se kjo është formula e zgjidhjes së krizës.
“Der Spiegel”



Putini “i thjeshtëzuar”

NGA GEORGY SATAROV

Moskë – Tre javë para fitores së tij të parë në zgjedhjet presidenciale, Vladimir Putin, publikoi në mars të vitit 2000, librin e tij në kulmin e fushatës zgjedhore “Biseda me Vladimir Putinin”, bazuar tek 24 orë intervista me tre gazetarë. Me shprehje si “Jeta është një gjë kaq e thjeshtë”, libri zbuloi një filozofi të rëndësishme, që do të karakterizonte stilin e tij të udhëheqjes: Thjeshtësia mund dhe duhet të imponohet ndaj një bote komplekse.

Ky botëkuptim, i cili sot përshkon udhëheqjen e Moskës, nuk u zhvillua nga vetë Putini; ai u prezantua zyrtarisht nga një think tank, i themeluar në dhjetor të vitit 1999 dhe të drejtuar nga German Gref, i cili më vonë do të bëhej Ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe Tregtisë nën Putinin.

Në pritje të fitores së Putinit, Qendra e Gref për Kërkime Strategjike, ftoi ekspertë për të hartuar dy programe – një të fokusuar tek ekonomia dhe tjetri tek reforma e administratës publike – në bazë të një direktivë themelore: të mos i komplikonin gjërat.

Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, ideologjia, politikat dhe veprimet e Putinit, e pasqyrojnë fiksimin e tij ndaj thjeshtësimit të sistemeve dhe strukturave. Ndarja e pushteteve në qeveri, është shumë joefikase, prandaj presidenca duhet të dominojë të gjitha degët e tjera.

Numri i madh i partive politike, secila me platformën e vet, është diçka shumë e komplikuar, kështu që duhet të zëvendësohet nga një listë eshkurtyr e disa partive më të pranueshme, me një përfaqësim kryesor (dhe të përhershme) të pushtetit.

Liria e shprehjes favorizon kakofoninë joproduktive të kritikave, kështu që media duhet të marrë direktiva të qarta, të cilat duhet të kihen parasysh gjatë raportit-

mit të lajmeve. Ka pasur gjithashtu, sipas regjimit të Putinit, shumë institucione publike që kryenin shumë aktivitete me mbikëqyrje të pamjaftueshme, kështu që ato u reduktuan në numër, dhe iu dhanë detyra të veçanta nga një listë e shkurtër dhe e centralizuar prioritetesh.

Shumë Gjykata të Larta ishin shumë të vështira për t'u kontrolluar, kështu që një gjykatë e vetme i zëvendësoi ato. Ashtu si sistemet dhe institucionet, zgjidhja e problemeve gjithashtu u thjeshtëzua. Në vend të zhvillimit të një zgjidhje të nuancuar për një problem shumëpërmasor- një qasje që do të përfshinte një mendim të kujdesëshëm, për të mos përmendur gabimet dhe rregullimet – çdo çështje, nga korrupsioni zyrtar tek menaxhimi i biznesit, shihej si njëpërmasore.

Neveria e regjimit të Putinit ndaj kompleksitetit të gjërave, është intensifikuar me kalimin e kohës, duke lëvizur nga besimi relativisht i parrezikshëm se thjeshtësia përkthehet në qartësi, përshtatshmëri, parashikueshmëri dhe në fund në siguri, tek përfundimi i rrezikshëm se kompleksiteti vetë – në thelb i paparashikueshëm e shpesh i padepërtueshëm – përbën një kërcënim.

Idetë dhe institucionet komplekse ose të ndërlikuara, shihen si një produkt i një force të errët, e prodhuar qëllimisht nga ana e armikut për të prishur planet dhe lënduar Rusinë, duhet të prishen me çdo kusht. Kjo perspektivë bardh e zi, mund të duket si një vijimësi e botëkuptimit të epokës sovjetike. Por, në vitet '90, Rusia kishte shënuar një përparim të rëndësishëm drejt modernizimit – dhe jo vetëm për shkak se filloi të adoptojë institucionet shtetërore të stilit perëndimor.

Në fakt, motori kryesor i modernizimit të Rusisë ishte formimi i një rendi të ri shoqëror, të bazuar tek liria, diversiteti dhe vetëdija se bota moderne, është e pasur me mundësi për vetë-aktualizim, qoftë kjo në arte, biznes, shkencë apo dhe politikë. Por, para se një shoqëri moderne dhe e hapur të krijohet plotësisht ose mentaliteti i lidhur me të, të ngulitej thellë në vetëdijen e shoqërisë, ai ishte pushtuar nga qasja e “e thjeshta është më e mira” e Putinit.

Pikëpamja se mundësia individuale dhe heterodoksia, duhet të kishin vartësi ndaj parashikueshmërisë, e nxiti elitën politike për të kërkuar gjithëdijeninë dhe cilësuar ndërhyrjet nga jashtë, si kërcënimin kryesor për të ardhmen e Rusisë. Të nxitur nga këto besime, një grup “liberalësh” u përpoqën të sjellin një lloj modernizimi burokratik, duke e bindur veten se rezultatet e politikave liberale mund të orkestrohen disi nga burokracia e korruptuar, përmes institucioneve të kufizuara demokratike. Dhe nuk është çudi fakti që ata dështuan.

Brenda pak viteve, u bë e qartë se në një botë të pashmangshëmrisht komplekse, zgjidhjet e “thjeshta” jo vetëm që nuk japin rezultate, por gjithashtu se kufizimet në demokraci, së bashku me kontrollin burokratik nga lart-poshtë, krijojnë kushte ideale për pasurim personal. Shkatërrimi i institucioneve demokratike, tanimë po nxitet edhe nga dëshira për thjeshtësi si dhe nga lakmia pastër. Fjala e urtë ruse “Thjeshtësia është më e keqe se vjedhja”, u provua çuditërisht të ishte kaq shumë parashikuese.

Viktima e fundit, në mëtimin e regjimit të Putinit për thjeshtësi, është shkenca. Ndërsa shkenca fillimisht nuk u vlerësua si një kërcënim, me rendin e saj shumë të kufizuar social dhe politik në kohën e sotme, është shfaqur si një simbol i autonomisë dhe diversitetit. Kjo është arsyeja pse, pasi u rizgjodh (në mënyrë të paligjshme) në mandatin e tij të tretë si president, Putin deklaroi kontrollin e plotë mbi Akademinë ruse të Shkencave.

Kohët e fundit, Ministria e Drejtësisë e futi Fondacionin “Dinastia”, i themeluar në vitin 2002 nga shkencëtari i mirënjohur në fushën e telekomunikacionit dhe manjati Dimitri Zimin, në listën e “agjentëve të huaj”, me gjasë me synim mbytnjen e përpjekjeve të organizatës për të ndërtuar një komunitet shkencor modern në vend.

(“Financimi i huaj”, që merr fondacioni – arsyeja pse ai u godit- vjen sipas Zimin, nga llogaritë e veta bankare.) Ky repressio, ka patur një ndikim serioz në komu-

nitetin shkencor, me mendjet më të mëdha të shkencës në Rusi – që nuk kanë më dëshirë të qëndrojnë në një ambient, ku lakmia dhe korrupsioni, mbyt krijimtarinë dhe eksplorimin – duke iu bashkuar kësioj investitorëve dhe kapitalit që largohen nga vendi.

Nga viti 1990 dhe deri në 2010-ën, rreth 70 përqind e matematikanëve kryesorë të Rusisë dhe gjysma e fizikanëve teoricienë, u larguan nga vendi për një jetë më të mirë. Biologë, kimistë, inxhinierë dhe ekspertë të tjerë, kanë emigruar gjithashtu në kërkim të mundësive më të mira.

Këto tendenca kanë prirje vetëm të përshpejtohen, teksa regjimi i Putinit po i shton sulmet e tij në këtë fushë.

Atmosfera shtypëse e grisë, imponimit qeveritar të thjeshtësisë, më në fund ka depërtuar në çdo sferë të jetës ruse. Dikish shpreson se kur të përfundojë sundimi i Putinit – siç në mënyrë të pashmangshme do të ndodhë, ndoshta edhe më shpejt sesa mendohet -rusët do ta kuptojnë se rruga drejt një shoqërie të hapur, moderne nuk është kurrë e thjeshtë.

Project Syndicate



Mohimi i rrezikut rus nga Evropa

Gjasat e Putinit për të lëvizur drejt Balltikut dhe Evropës Qendrore mbeten tejet te larta.

NGA ANDREW A. MICHTA

Edhe pse ende u duket kundërproduktive shumë vetëve, rreziku i luftës në Europë nuk ka qenë kurrë më parë kaq i lartë, që prej fundit të Luftës së Ftohtë. As liderët e fuqive të mëdha të Evropës, nuk kanë qenë kurrë më herët kaq shumë mohues, në lidhje me objektivin politik të Vladimir Putinit – rivendosjes së sferës së influencës nga ana e Moskës – apo sesa shpejt lufta në Ukrainë mund të shndërrohet në një konflikt më të gjerë, përgjatë kufirit verilindor të kontinentit. Pavarësisht retorikës së ashpër dhe paralajmërimeve të përsëritura për Putinin nga udhëheqja e NATO-s, shumica e kryeqyteteve të Evropës dhe Uashingtoni se çfarë do të ndodhë, nëse ai përpiqet të shkaktojë probleme përtej vijës së kuqe të Aleancës, niveli i përgjithshëm i gatishmërisë ushtarake në Evropë, për t'iu përgjigjur një krize të përshkallëzuar në mënyrë të beftë, mbetet i pamjaftueshëm. Pas vitesh të tëra të shkurtimesh të shpenzimeve të mbrojtjes, aleatët evropianë janë tashmë në një situatë ku mezi ofrojnë një të katërtën e aftësive ushtarake të NATO-s, me një numër vendesh të paafta për të vepruar jashtë territoreve të tyre kombëtare – një kusht ky thelbësor i përgjigjes aleate, në një rrethanë të paparashikuar. S'mund të mohohet fakti se dobësia e përgjithshme ushtarake e Evropës,

ka luajtur një rol në llogaritjet e Ruisë, jo vetëm gjatë aneksimit të Krimesë dhe përshkallëzimit të konfliktit në rajonin lindor Ukrainas të Donbasit, por që në luftën e vitit 2008 kundër Gjeorgjisë, sfida e parë e drejtpërdrejtë Putinit ndaj rendit normativ të sigurisë, megjithëse jo ende të vetë Evropës.

E thënë thjesht: dobësia shkakton agresionin e mëtejshëm.

Putin ka qenë i suksesshëm në ecjen përpara me projektin e tij, për të rivendosur një sferë e interesi të privilegjuar të Ruisë në Evropën Lindore, kryesisht për shkak se përgjigja perëndimore ka qenë e dobët dhe kontradiktore. Me Shtetet e Bashkuara, të hutuara nga shpërbërja e Lindjes së Mesme dhe konkurrencës në rritje gjeostrategjike të Kinës, përballja me agresionin e Ruisë në Ukrainë u shndërrua në një projekt evropian, ose më saktë gjerman, me Uashingtonin që ofron mbështetje.

Vetëm kohët e fundit, SHBA-ja ka filluar të lëvizë përtej stërviitjeve ushtarake, duke ofruar pajisje për Poloninë dhe shtetet balltike.

Në pjesën më të madhe, retorika e lartë bombastike që e dënon agresionin e Ruisë, është shoqëruar me gjysmë-masa, përsa i përket sanksioneve ekonomike, dhe çerek-masa ose më pak, kur është fjala për një përgjigje ushtarake.

I ashtuquajtur "rigarantim" i aleatëve të NATO-s përgjatë kufirit verilindor, deri më tani ka rezultuar në stërviitje të kufizuara ushtarake, me trupat amerikane që shëtisin në rajon dhe kthehen sërish në bazën e tyre në Gjermani, dhe me vendimin më të fundit për të vendosur tanke dhe pajisje në një pozicion të paracaktuar për 5 mijë trupa.

Ndërkohë Perëndimi ç'armatoset

Qëkur Berlioni pati deklaruar që në fillim se "nuk ka zgjidhje ushtarake" në Ukrainë, Kievi është bërë në një vend strategjik i askujt, dhe është çështje kohe para se faktorët e kombinuar ekonomikë dhe ushtarakë, të sjellin dështimin e shtetit dhe më tej ndarjen e tij.

Por pa ndihmën e konsiderueshme ushtarake ndaj Ukrainës për ta armatosur ushtrinë e saj, Rusia mund të mendojë lirshëm hapat e mëtejshëm, qoftë ky një tjetër aksion në Ukrainë apo nxitjen e tensioneve etnike në Balltik, ose ruajtja e kushteve aktuale gjysmë të ngrira në vend ose zgjedhja për të përshkallëzuar situatën.

Nëse kjo e fundit ndodh, ky inkursion në territorin e NATO-s, do të testojë besueshmërinë e Aleancës, në një kohë kur konsensusi mbi solidaritetin e aleatëve është në dyshim. Rreziku i luftës në Evropë, është rritur paralelisht me demilitarizimin progresiv të kontinentit, si në aspektin e trupave dhe pajisjeve, ashtu edhe në imazhin e përgjithshëm publik. Shpenzimet e mbrojtjes në thuajse të gjitha vendet evropiane të aleancës janë zvogëluar në 1.5 përqind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, dhe vazhdojnë të bien më tej.

Kontributi i Evropës tek aftësitë ushtarake të NATO-s, që një dekadë më parë përbënte rreth gjysmën e forcës së saj, sot është në më pak se 25 përqind, dhe kjo shifër është gjithashtu në rënie. Disa vende në Evropë, duke përfshirë edhe ato të mëdha, e kanë dhjetuar armatimin e tyre, duke vënë kështu në pikëpyetje gatishmërinë e tyre për të dislokuar në fushëbetje më shumë se disa mijëra trupa. Situata është edhe më e tmerrshme, kur bëhet fjalë për logjistikën dhe transportin. Sot, Shtetet e Bashkuara sigurojnë 70 përqind të të gjitha shpenzimeve të mbrojtjes të NATO-s. Procesi i demilitarizimit të Evropës gjatë dekadës së fundit, ka përkuar me modernizimin ambicioz ushtarak të Ruisë, me një shumë prej 700 miliardë dollarësh, dhe programet që synonin të prezantonin gjeneratën e ardhshme të forcave të blinduara, avionë dhe raketa dhe modernizimin e forcave bërthamore.

Edhe pse shpenzimet e Ruisë, s'mund të krahasohen me buxhetin e mbrojtjes së SHBA-së, të dhënat tregojnë një ndryshim të rëndësishëm të paradigme, kur merret në kontekstin e ekuilibrave të pushtetit rajonal në rajonin e Evropës Qëndrorë Nordike dhe Balltike.

Rusia ndërkaq, gëzon avantazhin e qartë të pasjes tashmë të programeve konkrete, ndërsa skandinavët, balltikët dhe polakët po përpiqen të mbushin boshllëqet në sistemet e mbrojtjes ajrore dhe raketore, si dhe forcave kundër mjeteve të blinduara, dërsa të gjithë kërkojnë nga Shtetet e Bashkuara t'u ofrojë siguri dhe një sasi e vogël parandalimi kundër Ruisë.

Pavarësisht nga përpjekjet e lavdërueshme të polakëve dhe balltikëve- Polonia dhe Estonia janë tashmë ndër 5 vendet e NATO-s, përfshirë Shtetet e Bashkuara, që në fakt plotësojnë 2 përqind të PBB-së, sipas zotimit të dhënë në samitin e fundit të NATO-s – angazhimet e tyre për modernizime të reja, s'mund të kompensojnë prirjen e përgjithshme të rënies së vazhdueshme të shpenzimeve të mbrojtjes në të gjithë Evropën dhe NATO, që sipas vlerësimit të vetë Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, do të tkurret përsëri nga 942 miliardë dollarë në vitin 2014 në 892 miliardë këtë vit.

Rreziku më i madh i përshkallëzimit të kërcënimit mbetet tek shtetet balltike, të cilat janë ende në një masë të madhe të pambrojtshme në rastin e një konflikti total me Rusinë, dhe madje do ta kishin të vështirë për t'u përshtatur me një skenar hibrid, në të cilin Putini e ngriti enklavën ruisht-folëse, për të testuar kohezionin dhe aftësinë e NATO-s për t'u kundërpërgjigjur.

Mbështetja e Moskës për konfliktin që zien në Ukrainën Lindore – në të cilin ajo mund të nisë një offensive tjetër – dhe retorika luftarake kundër aleancës së NATO-s, ndërhyrja në hapësirën ajrore, dhe stërvitjet në formën e bombardimeve kundër caqeve skandinave dhe të Evropës Qëndrore, që u rritën në mënyrë eksponenciale vitin e kaluar, u kombinua me shantazhin e Ruisë kundër NATO-s se do të përdorë armët bërthamore, me kërcënime për dislokimin e mbushjeve shtesë në Kaliningrad dhe Qarkun Ushtarak Perëndimor.

Duke pritur të papriturën

Duhet gjithashtu të jetë e qartë se Vladimir Putin, është i vendosur të rrisë presionin, pavarësisht sanksioneve ekonomike dhe kundërlëvizjeve të NATO-s, për shkak se ai i ndjen mosmarrëveshjet mes aleatëve, sidomos kur është fjala që evropiano-perëndimorët t'u vijnë në ndihmë aleatëve të tyre të rinj në Balltik dhe rajone të Evropës Qëndrore.

Rreziku i një lufte në Evropë, është më i madh sot se një vit më parë, për shkak se aleatët nuk e shfrytëzuan kohën kur samiti i Uellsit dërgoi një mesazh të qartë përforcimesh dhe parandalimi përgjatë kufirit rus të NATO-s. Putin është ende i bindur se loja e përshkallëzimit dhe de-përshkallëzimit të tensioneve ka ende vend për t'u luajtur.

Në fund të fundit, është diccka akademike të përpiqesh të marrësh me mend qëllimet përfundimtare të Putinit, dhe debatuar nëse ai do të jetë i kënaqur me fitimet aktuale territoriale në Ukrainë, apo të shkojë më tej.

Ajo që ne dimë, është se ç'kuilibri i pushtetit në rajonet e Evropës Qëndrore, Veriore dhe Balltike përbën kërcënimin e vërtetë të luftës, dhe se pa baza të përherëshme të SHBA-së dhe aleatëve, në vendet përgjatë kufirit të NATO-s. s'mund të ketë përmbajtje të mjaftueshme kundër një veprimi të supozuar rus, qoftë kjo luftë hibride apo konvencionale.

Për ata në gjirin e udhëheqjes politike të Evropës dhe komunitetin e analistëve, që vazhdojnë të mos e besojnë një skenar të tillë ekstrem, kini parasysh sa pak besonin se ishte e mundur një vit më parë që Krimea të pushtohej dhe aneksohej nga Rusia, dhe Ukraina të zhytej në luftë. Kur është fjala për Rusinë e sotme të Putinit, prisni të papriturën – ose më mirë të njëjtën sjellje.

Shënim: Andrew A. Michta është profesor në Naval War College në SHBA dhe një anëtar i Qendrës për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS).



Origjina e harruar e krizës greke. Mendohuni dy herë për fajtorët

Një anekdotë me grekë, francezë e gjermanë. Një shpjegim i origjinës më të thellë të krizës ku ndodhet Greqia sot. Dhe një histori më pak e njohur, për fajtorët e vërtetë. Që shpjegon përse “banakierët” francezë dhe gjermanë vazhduan t’u shërbejnë papushim alkool “klientëve grekë”

NGA ANA SWANSON

Ndalomëni, nëse e keni dëgjuar një herë këtë!

Grekët, italianët, spanjollët dhe irlandezët hyjnë në një bar, ku francezët dhe gjermanët janë banakierë. Eshtë “happy hour” dhe gjermanët e francezët po ofrojnë pije me gjysmë çmimi. Ndonëse të gjithë pijnë shpejt e shpejt dhe me tepri, banakierët vazhdojnë t’u shërbejnë. Të gjithë klientët e dehur tashmë shkojnë në shtëpi, dhe futen në gjithfarësoj telashesh - sherre, aksidente me makinë, ndonjë dritare e thyer...

Atëherë, kush e ka fajin? Eshtë e qartë që grekët nuk duhej të kishin pirë kaq shumë. Megjithatë, francezët dhe gjermanët gjithashtu nuk duhej të vazhdonin t’u shërbenin grekëve, kur këta ishin të dehur -sidomos nëse francezët dhe gjermanët nuk do të donin të kishin dritare të thyera në lagjen e tyre.

Fatkeqësisht, kjo nuk është shaka. Pas një periudhe qejfi që zgjati shumë, grekët janë tashmë kokë e këmbë të zhytur në krizë financiare, dhe po tërheqin me vete edhe ekonominë e Europës. Në ditët e fundit, Greqia ka shkelur afatin e pagimit të një kësti të rëndësishëm për FMN-në, si dhe ka mbyllur bankat e saj, për të mos lejuar largimin nga vendi të sasive të mëdha të parasë. Të dielën vendi do të mbajë një referendum, nëse duhet të miratojë masat e ashpra të kursimit që kërkon Europa - një vendim që do të përcaktojë edhe nëse Greqia do të qëndrojë në Eurozonë. Një pjesë e arsyeve të krizës janë të qarta për këdo që ka sy të shohë. Greqia ka shumë probleme ekonomike të gjithëpranuar: Sektori publik i vendit është i fryrë dhe i kapur nga korrupsioni masiv, dhe shumë analistë thonë se vendi i ka manipuluar regjistrat financiarë për të fshehur sasinë reale të borxhit para pjesës tjetër të Europës.

Ka shumë probleme të mirëdokumentuar, që burojnë nga projekti i vetë euros - pra që vendet anëtarë ndajnë një monedhë të përbashkët, ndonëse kanë politika të ndryshme taksimi dhe shpenzimesh. Pra, kjo do të thotë që, ndonëse punëtorët grekë nuk janë aq konkurrense ekonomikisht sa gjermanët, Greqia nuk mundet ta ulë vlerën e monedhës së saj, për t'i bërë produktet e vet më të lirë jashtë dhe për të stimuluar eksportet.

E njëjta gjë ka vlerë për inflacionin, ku Greqia mund të përfitojë prej një norme më të lartë inflacioni, që do ta bënte borxhin më pak të kushtueshëm me çmimet e sotëm, ndërkohë që Gjermania ka një "alergji" historike, ndaj çdo politike që mund të stimulojë inflacionin.

Origjina e thellë

Ka edhe disa ide të tjera, në lidhje me origjinën më të thellë të krizës greke, të cilat mund të mos i keni dëgjuar shpesh. Sapo Greqia hyri në Euro në vitin 2002, ajo mund të merrte hua me norma shumë të ulëta interesi, duke qenë se tashmë huamarrja e grekëve kryhej nën garancitë kontinentale. Kjo i bëri grekët që të rrisin në mënyrë dramatike sasinë e borxheve që merrnin. "Por duke qenë se rritja ekonomike ishte e lartë, askush nuk shqetësohej me të vërtetë për këtë gjë", thotë Matthias Matthijs, profesor në Universitetin "John Hopkins" dhe autor i "E ardhmja e Euros", i cili na ofroi edhe metaforën e barit dhe banakierëve.

Mes viteve 1998 dhe 2007, rritja ekonomike vjetore e Greqisë për frymë, ishte 3.8 përqind - norma e dytë më e lartë në Europë. Por në brendësi kishte shumë dobësi. Ekonomia që lulëzonte në Greqi dhe vende të tjerë, si Irlanda dhe Spanja, shkaktoi rritjen e çmimeve, dhe këta vende ofruan rritje bujare të pagave për punëtorët, gjë që i bëri më të kushtueshëm eksportet e tyre. Kjo i bëri më pak konkurrense, por përderisa po rriteshin kaq shpejt ekonomikisht, për ta pak rëndësi kishte. Pastaj goditi kriza financiare. Teksa rritja ekonomike u ngadalësua, dobësitë konkurrense të këtyre vendeve dhe borxhet e papërbalueshëm krejt papritur dolën qartë në shesh. "Kur ikën dallga, atëherë mund ta shohësh se kush po noton lakuriq", thotë Matthijs.

Historia më pak e njohur

Matthijs thotë se ka edhe një version më pak të njohur, dhe që ai e konsideron më bindës. Praktikisht, thotë ai, ky version shërben për të shpjeguar përse banakierët vazhduan të shërbejnë.

Në mesin e viteve nëntëdhjetë, edhe përpara se të kishte lindur tregjet vënë një bast të madh se Euro do të bëhej realitet. Sidomos investitorët, pjesa më e madhe në Europën veriore, vënë bast se normat e interesit në Europën veriore dhe jugore do të konvergonin. Në atë kohë, normat e interesit në Europën jugore ishin shumë më të larta se sa në Europën veriore, thjeshtë sepse njerëzit mendonin që investimi në vende si Greqia kishte shumë më tepër risk se sa investimi në vende si Gjermania.

Në pritje të krijimit të eurozonës, investitorët hodhën shumë para për bonot e lira dhe me fitim të lartë të Europës jugore. Kjo gjë solli nxitjen e huamarrjes dhe

një bum ekonomik në vendet jugore.

Në fund, investitorët kishin të drejtë - normat e interesit të Greqisë, për bonot me afat 10 vite, ranë nga 20 përqind në fillimin e viteve 1990, në 3 përqind në vitin 2002. “Ata në veri fituan shumë para duke parashikuar kundër normave më të larta të interesit atje. Kjo gjë nxiti bum, përpara se të vinte Euro, e cila i mbinxehu këto ekonomi”.

Teksa ekonomitë u mbinxehën, nuk është habi që konkurueshmëria mori goditje, thotë Matthijs.

Shkurt, shumë prej veriorëve punuan fort për një regjim financiar i cili nuk i shkonte ekonomisë greke, për arsye se ata do të përfitonin. Shumëkush me të drejtë fajëson grekët për krizën aktuale, por një pjesë e fajit i takon edhe veriut të largët, argumenton ai. Matthijs e krahason situatën me krizën e SHBA. Kush e kishte vërtetë fajin për krizën e tregut të banesave në SHBA: Huamarrësit që blenë shtëpi të cilat nuk mund t'i përballonin, apo huadhënësit predatorë që i nxitën të blinin? “Gjermanëve nuk u pëlqen ai krahasim. Por ata ishin shumë të babëzitur. Ata donin bonot me fitime më të lartë atje, ata donin të investonin atje”, thotë ai për Europën jugore.

The Washington Post



Greqia sapo u dha një leksion kapitalistëve, se për kapitalizmin

JIM EDWARDS

Greqia ka votuar që të mos e paguajë këstin e borxhit të saj për FMN-në dhe BE-në, dhe është një humbje e madhe për Angela Merkelin e Gjermanisë dhe trojkën që ajo udhëhiqte, që këmbëngulte se për Greqinë nuk kishte rrugëdalje tjetër, përveç se të paguante borxhin e saj të madh.

Votimi është një leksion shumë i madh për konservatorët, dhe për këdo që beson se kjo ka të bëjë me një qeveri diletante, me idealistë që mendojnë se munden ta shpërfillin ligjin, ndërkohë që vënë në zbatim një lloj ëndrrë Che Guevar-eske. Gabim.

E vërteta është, që ky është kapitalizmi.

Që në krye të herës, Merkeli dhe BE-ja kanë vepruar nga pozicioni që, për arsye se Greqia merrte vazhdimisht borxhe, tani Greqia duhet që t'i shlyejë Ai pozicion supozonte, çuditërisht, që borxhi funksionon vetëm me një drejtim: nëse i jep dikujt para hua, ata më pas t'i kthejnë.

Por tregjet e lirë NUK funksionojnë kështu.

Borxhi nuk është një garanci për shlyerjen e plotë të pagesave në të ardhmen. Borxhi është një risk që e ndërmarrin kredidhënësit, me shpresën që ndoshta

nesër do të paguhen.

Fjala kyçe këtu është "RISK".

Nëse je i gatshëm ta ndërmarrësh riskun, do të kesh shpërblim - në formën e interesit.

Por ana negative e atij risku është se ti humbet para. Dhe Greqia sapo e sfidoi Gjermaninë në bllofin e kësaj të fundit.

FMN i dha hua Geqisë 1.5 miliardë Euro, që duhej të shlyheshin në qershor, dhe Greqia nuk po i paguan. Greqia ka edhe 3.5 miliardë Euro të tjera që duhet t'ia paguajë Bankës Qendrore Europiane në korrik, dhe në këto momente duket vërtetë e dyshimtë që do e shlyejë këtë borxh.

Kështu funksionon kapitalizmi. Fakti që u desh që një qeveri e zgjedhur demokratikisht - zyrat e të cilës janë të mbushura me postera të Leninit, Engelsit dhe Guevarës - për t'i dhënë këtë mësim Gjermanisë, është vërtetë i habitshëm. Edhe më tronditës është fakti që Merkeli dhe të tjerët e dinin që Greqia nuk mundej të shlyente këtë borxh, përpara se të nisnin këto negociata. Vlerësimi i vetë FMN-së për borxhin grek, i botuar vetëm disa ditë më parë, thotë: "Duke patur parasysh borxhin ekzistues shumë të lartë, këto nevoja të reja financimin e bëjnë të papërballueshme dinamikën e borxhit..."

"Të papërballueshme!" Bankierët e vetë Gjermanisë e dinin që Greqia nuk mund ta shlyente borxhin. Dhe megjithatë, Merkeli këmbënguli.

Hidhini një sy GDP-së së Greqisë. Për të shlyer borxhet, duhet që të kesh një ekonomi që rritet. Ky është një ligj bazë i ekonomisë. Kështu funksionojnë kartat e kreditit. Kështu funksionojnë kolateralët. Dhe kështu funksionojnë borxhet sovranë / borxhet e bankave qendrore. Por ekonomia e Greqisë nuk ka qenë asnjëherë në një pozicion ku mund të përfitonte nga borxhi, sepse ajo ka vite që tkurret.

Ka edhe një tjetër fakt, të cilin grekët e dinë mirë (por që gjithë të tjerët e kanë harruar). Në fillim, Greqia u detyrohej për këtë borxh bankave private të investimeve, si Goldman Sachs. Por, FMN dhe BQE morën vendimin vetëvrasës që të lejonin këto banka private ta transferonin atë borxh tek institucionet e BE-së dhe FMN, "për të shpëtuar" Greqinë. Ish presidenti i Bankës Qendrore Europiane, Jean Claude Trichet këmbënguli që të ndodhte ky transferim i borxhit. "Ne jemi një union ekonomik dhe monetar, dhe nuk duhet të ketë ristrukturim borxhi!" tha Trichet në një prej mbledhjeve. Duke bërë titur.

Rezultati ishte që BQE bëri këtë marrëveshje idiote dhe katastrofike me Greqinë. Kështu që, nuk pati marrëveshje për ristrukturim borxhi të Greqisë. Vendi i shleu menjëherë borxhet që i kishte sektorit financiar privat - kryesisht banka investimesh - dhe tashmë barra e borxhit iu transferua taksapaguesve europianë. Qeveria ra dakord për një paketë shumë të vështirë shkurtimesh të shpenzimeve, si dhe reformash strukturore, në këmbim të huave 110 miliardë Euro të shtrira në tre vite.

Trichet bëri një gabim kolosal dhe elementar. Për definicion, vendi i duhur për borxhet me risk është në tregjet financiare, si Goldman. E gjithë ideja e investimeve në borxhin privat është që këta kredidhënës janë të përgatitur për "qethje". Risku nuk duhet mbartur absolutisht nga bankat qendrore, të cilat për masat e shpëtimit mbështeten tek paratë e taksapaguesve.

Nëse Trichet do të kish marrë vendimin e kundërt - dhe do e kish lënë borxhin grek me Goldman dhe të tjerët - atëherë votimi i djeshëm do të kish qenë një shënim në fund të faqes, dhe jo një titull kryesor në gazeta dhe në histori. "Goldman Sachs e pëson nga borxhi grek", do të thoshin titujt. E kujt i bëhej vonë? Sigurisht, aksionerëve dhe klientëve të Goldman. Por nuk do të kish shkaktuar një krizë në zemër të BE-së.

Tani, Italia, Spanja dhe Portugalia po shohin me vëmendje nga Greqia, dhe mendojnë, hej, mos vallë do të futemi dhe ne në këtë telash? Tani, përpara se të

fillojmë të këndojmë “Flamuri i Kuq” dhe të nxjerrim nga arkivat video të vjetra të “Rinisë” që feston, le të injektojmë disa nota realizmi. Greqia nuk është në fakt një vend me socialistë të çmendur, të cilët nuk e kuptojnë si funksionojnë tregjet. Në fakt, një pjesë e madhe e problemeve të saj me mbledhjen e taksave buron nga fakti që ka dy herë e gjysmë më shumë të vetëpunësuar dhe biznese të vegjël në Greqi, se sa ka mesatarisht në shtetet e tjerë. Dhe bizneset e vegjël janë ekspertë në shmangien e taksave. Konservatorët që urrejnë të paguajnë taksat dhe që u bëjnë thirrje bizneseve të vegjël që të ndjekin strategji për shmangien e taksave, duhet të mbajnë shënim: Endrra juaj sapo u bë realitet në Greqi.

Nëse Greqia do të ishte më socialiste - më shumë si Gjermania, me korporatat e saj gjigande që kanë forca punëtore të sindikalizuara, që paguajnë taksa nga pagat e tyre - atëherë mbledhja e taksave do të ishte shumë më e lartë në Greqi.

Greqia është tashmë një “endacak” në tregjet e borxheve. Ndoshta do i duhet të fillojë të emetojë dhrahmi. Nuk do të ketë qasje në kredimarrje. Sigurisht, vaji i ullirit, djathi feta dhe rakia do të bëhen krejt papritur mallra shumë pak të kush-tueshëm në tregjet e eksporteve. Turizmi në Greqi do të bëhet i mrekullueshëm. Por, situata në përgjithësi do jetë e tmerrshme. Papunësia do të rritet dhe ekonomia e Greqisë do të shpërthejë nga brenda.

Por tmerrri do të jetë vetëm i Greqisë. Greqia ka hyrë tashmë në rrugën e saj. Ajo po e vendos vetë fatin e saj.

Business Insider



Analiza e Der Spiegel: Si dështoi Merkeli me Greqinë dhe Evropën

NGA PETER MÜLLER DHE RENÉ PFISTER

Angela Merkel, po e shijon reputacionin e saj si mbretëresha e Evropës. Por ajo nuk ka mësuar sesi ta përdorë fuqinë e saj, duke lejuar një situatë të keqe të përshkallëzohet deri në një pikë vlimi. Paaftësia e saj, për të marrë qëndrime jopopullore, e përkeqësoi më tej krizën greke.

Merkel është e njohur për mungesën e empatisë. Ajo ka vepruar kështu, pjesërisht për shkak se ka një kontroll të fortë ndaj ndjenjave të saj. Për këtë arsye, ajo mbeti e heshtur gjatë gjithë fundjavës së shkuar, pavarësisht zhvillimeve dramatike në lidhje me krizën greke. Ndërkohë gjatë një takimi së fundmi me drejtuesit kryesorë të Unionit Kristian Demokrat, ajo la të kuptohet se ishte thellësisht e zhgënjyer nga kryeministri grek Aleksis Cipras. Politikat e tij janë “të vështira dhe ideologjike”-tha ajo, duke shtuar se ai po e izolon vendin e tij.

Merkel e kishte përshkruar gjithmonë Ciprasin, si një njeri që edhe pse drejtonte një organizatë të çmendur, ishte mjaft e hapur dhe i përshtatej situatave. Ajo kishte shpresuar se Cipras në fund të fundit, do të ndihmonte që të mbizotëronte arsyeja. Megjithatë, tashmë duket se Cipras i ka lënë në derë zonjës Merkel, dëshimin më të madh të saj si kancelare.

S’ka mbetur asgjë përveç frikës

Natyrisht në fund, do të jetë faji kryesisht i qeverisë radikale greke, që vendi po shkon drejt largimit nga eurozona. Si duhet të merresh me një kryeministër, që i kryen negociatat, duke përdorur gjuhën e mobilizimit ushtarak? “Ne kemi të drejtën në anën tonë. Nëse arrijmë të kapërcyjmë frikën, atëherë nuk ka mbetur gjë tjetër veç saj”- shkroi Cipras në tuiet pak ditë më parë.

Por përçarja, që tani është hapur edhe në Evropë, ka diçka të bëjë me stilin e udhëheqjes së Merkel - dhe me origjinalitetin për të lejuar gjërat domethënëse, të

rrjedhin lirshëm për një periudhë të gjatë. Kjo metodë funksionon kur vjen puna për të negociuar mbi një kompromis, dhe kur të gjithë palët e përfshira janë të interesuara për një rezultat të favorshëm. Por ajo ka kufizime të dukshme, kur dikush si Cipras është i vendosur t'i çojë gjërat në ekstrem.

Ka qenë prej kohësh e qartë, se Greqia përbën një rast të veçantë në kontekstin e krizës së euros. Ai është një vend, ku nuk funksionon as sistemi i taksave dhe i regjistrimit të tokës, një vend që është zhytur aq thellë në borxhe, sa që asnjë ekonomist i arsyeshëm, nuk beson se mundet ndonjëherë të paguajë atë që u detyrohet kreditorëve.

Përveç kësaj, partitë që zakonisht e zhvasnin shtetin, e drejtuan vendin për vite me rradhë. Pastaj erdhi Syriza, një lëvizje që të paktën në lagjet e tij radikale, ëndërroi përmbysjen e sistemit. Merkel e dinte të gjithë këtë. E megjithatë, u përpoq ta zgjidhë problemin me receta, që ajo i kishte përdorur më herët në politikën e brendshme gjermane: shtyrjen, fshehjen dhe lejimin që gjërat të mbeten të paqarta.

Nuk kishte asnjë mungesë të zërave paralajmërues. Ministri i Financave, Wolfgang Shojble, pati argumentuar prej kohësh, se Greqia duhet të nxirret jashtë euros. Kriza greke kërkonte udhëheqje dhe një plan, por Merkel nuk ishte e gatshme të ofronte asnjërin. Edhe pse asaj i pëlqen pushteti, kur vjen puna për ta ushtruar, ajo nuk e di se çfarë të bëjë me të. Dhe tanimë ajo përballet me mbeturinat e politikës së saj evropiane. Por si mbërritën punët në këtë pikë?

Politikat “McKinsey”

Për të kuptuar politikat e Merkelit, ia vlen të kthehemi disi pas në kohë në vitin 2003. Asokohe ajo ishte vetëm kryetare e CDU-së prej 3 vjetësh, dhe ishte në mes të hartimit të një axhende të re politike. Në Gjermani kishte 4.5 milionë të papunë, arkat e sigurimeve shoqërore ishin bosh, dhe punëdhënësit ankoheshin mbi barrën tepër të lartë të taksave.

Gjermania nuk aq keq sa është sot Greqia, por gjithësesi kishte nevojë urgjente për ristrukturim, dhe Merkel filloi të shpallë një program të rreptë reformash për vendin. Kompania e menaxhim-konsultimit “McKinsey”, mendoi për të llogaritur shifrat, që do të mbështesnin mesazhin e saj të hidhur mbi masat e kursimit. “McKinsey”, e specializuar në ofrimin e vërtetave të pakëndshme, dhe e punësuar zakonisht nga kompanitë, që kanë nevojë të shkurtojnë shpenzimet dhe punonjësit. Është më e lehtë për menaxherët, në qoftë se ata janë në gjendje të fshihen prapa analizës së konsulentëve. Ky është parimi i “McKinsey”. Merkel e zbatoi këtë parim edhe në politikën e saj.

Kur kriza në eurozonë shpërtheu në vitin 2010, ajo garantoj që Fondi Monetar Ndërkombëtar të përfshihen në ristrukturimin e borxhit të Greqisë. Ajo e bëri këtë kundër vullnetit të shefit gjerman të Financave, Shojble, i cili besonte se Evropa duhet t'i zgjidhte vetë problemet e saj.

Në një farë kuptimi, Fondi Monetar Ndërkombëtar është “McKinsey” i politikës globale. Ai ndihmon kudo vendet që përballen me vështirësi financiare, duke dhënë kredi me kusht që vendet të bien dakord të ndërmarrin disa reforma. Gjithësesi, ideja fillimisht kishte kuptim. Një arsye pse Evropa u zhyt në krizë, ishte se kontinenti, në kulmin e euforisë së integritimit, i kishte kushtuar pak vëmendje shifrave të ekonomisë.

Qëllimi i afrimit të FMN-së, ishte rivendosja e matematikës në ekuacion. Por parimi i “McKinsey”, ra ndesh me pretendimin e Merkel për pushtet. Këshilltarët e saj, e portretizuan kancelaren si mbretëresha e Evropës, si dikush që formëson udhëzimet e saj. Por muajt e fundit, ajo është shfaqur si një grua e fshehur pas këshillave dhe rekomandimeve të ekspertëve të FMN - prapa “teknokratësh” siç u shpreh vetë Cipras.

Dështimi i vërtetë i Merkelit, është se ajo nuk ka vendosmëri të qëndrojë në rrugën e saj të menduarit. Së pari, ajo u fsheh pas troikës, sepse nuk donte të

ishte dikush që ofronte të vërtetat e hidhura qeverisë greke. Ajo ka ndjekur parimin “McKinsey”. Pastaj, kur kërkesat e Cipras u bënë gjithnjë e më urgjente, ajo u përkul ndaj logjikës së tij. Dhe zbatoi moton: “Kur ka një vullnet, ekziston një rrugëdalje”.

Në Gjermani, këto fjalë u interpretuan si një shenjë e vullnetit të mirë - dëshirë për ta mbajtur Greqinë në eurozonë. Por Cipras e interpretoi atë krejtësisht ndryshe: si një sfidë për të vendosur pikat mbi “i”.

Evropa e Merkelit

Askush nuk mund ta akuzojë Merkelin se nuk ka parime, kur është fjala për politikën e jashtme. Besnikëria e saj në SHBA është e pathyeshme, dhe fakti që telefoni i saj celular dhe i disa ministrive gjermanë është përgjuar nga NSA, nuk e ka ndryshuar këtë linjë.

Ajo qëndron me forcë përkrah Izraelit, ndonëse qeveria aktuale nuk ka bërë asgjë për të vendosur paqen me palestinezët. Dhe në fund, ajo ka arritur që të shkojë mirë me çdo president francez i cili ka qëlluar gjatë mandateve të saj në detyrë, madje edhe me Fransua Holondin, që bëri fushatë kundër kancelares gjermane dhe politikave të saj shtrënguese.

Megjithatë, pozita e saj në Evropë, është më pak e qartë. Kriza e euros, ka hapur një dimension të ri pushtetit të Merkel. Që prej viti 2010, ka pasur një seri të pafund samitësh mbi krizën në Bruksel dhe kancelarja gjermane, ka qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes. Por teksa Merkel gëzonte rolin e saj si mbretëresha e Evropës, ajo nuk ishte e zëshme si Gerhard Shreder dhe aq e fortë sa Helmut Kol.

Në vend të kësaj, ajo bëri atë që asnjë kancelar gjerman nuk e kishte bërë kurrë më parë: ndoqi politikën e imperializmit pedagogjik, duke bërë thirrje për disiplinë buxhetore, reforma të tregut të punës dhe privatizime. Kjo funksionoi në Spanjë, Portugali dhe Irlandë, por në Greqi, kushtet e imponuara nga kreditorët nuk u panë si ilaçe të nevojshme, por si një helm që po e shkatërronte shoqërinë. Merkel e pa se çfarë po ndodhte, por s’kishte guxim të përballej me pasojat. Dhe nuk është se nuk pati alternativa. Ajo mund t’i ofronte Greqisë një dalje të sigurtë dhe të mbështetur nga eurozona. Ky është kursi, që Ministri i Financave Shojble e ka mbështetur brenda vendit për vite me rradhë. Ajo gjithashtu mund t’i ofronte Greqisë një reduktim të ri të borxhit. Sikur Merkel ta kishte bërë këtë në momentin e duhur, së paku mund të kishte parandaluar radikalizimin e politikës greke. Sigurisht, asnjë nga këto opsione nuk do të kishte qenë pa rrezik. Ato do të kërkonin guxim dhe para, si dhe do ta linin zbuluar Merkelin nga sulmet e kritikëve. Dhe kjo është diçka, që ajo nuk e donte. Prandaj u fsheh pas troikës, pas teknokratëve të urryer, duke përshpejtuar kësisoj rritjen e Syriza-s.

Në fakt, Cipras është në një farë mase, një produkt i stilit të lëkundur të udhëheqjes së Merkel. Në kancelari, shumëkush ndihet i lehtësuar që Cipras nuk ishte në gjendje të përçante Evropën, dhe që askush nuk po fajëson Gjermaninë për ngërçin e tanishëm. Kjo mund të jetë e vërtetë, por ndërkaq ky është një këndvështrim i thjeshtëzuar. Sukses për Merkelin, është kur askush nuk po drejton gishtin ndaj saj.

Marrë me shkurtime nga “Der Spiegel”



Si u bë Greqia europiane. Arsyet që shkojnë deri tek Perandoria otomane

*PERANDORIA OTOMANE DHE HISTORIA E BORXHIT
GREK. Marrëdhënia e trazuar mes grekëve të sotëm dhe
fqinjëve të tyre në veri dhe në perëndim – ndonjëherë admirues,
ndonjëherë huadhënës, ndonjëherë kritikues – ndihmon për të
shpjeguar krizën e sotme*

NGA DAVID A. GRAHAM

Greqia është djepi i qytetërimit evropian, thonë, po a është ajo në Europë në fakt?

Përgjigja mund të duket e vetëkuptueshme: Vendi ndodhet në kontinentin evropian, sigurisht, dhe ai është pjesë e Bashkimit Evropian – të paktën tani për tani. Por pyetja është ngritur shpesh herë, dhe përgjigjet kanë qenë të paqëndrueshme, që nga fillimet e shtetit modern grek në shekullin 19. Negociatat në vazhdim, që mund të vendosin përfundimisht për anëtarësinë e Greqisë në BE, janë thjeshtë përpjekja më e fundit për të gjetur një përgjigje. Po të shohësh hartat e vjetra të Europës, Gadishulli i Ballkanit është i përfshirë, por ai është i shenjuar si “Turqi”. Kjo sepse nuk ka patur një Greqi të pavarur që nga koha e pushtimeve romakë, deri në vitin 1820; disa pjesë të Greqisë së sotme kanë qenë nën kontrollin oto-

man, deri në shekullin 20 madje. Greqishtfolësit nën pushtimin otoman e lidhën identitetin e tyre me fenë dhe kishën ortodokse, dhe jo me identitetin kombëtar, dhe e mendonin veten më shumë si romakë, se sa si grekë, më tha Molly Green, profesore e historisë dhe studimeve helenike në Princeton. Qendra e tyre kulturore do të kish qenë, jo Athina sot e mbuluar nga pluhuri, por Kostandinopoja kozmopolitane.

Megjithatë, në veri dhe në jug, mendimtarët europianë ishin të magjepsur prej klasicizmit dhe kishin filluar të adhuronin shembullin e lashtësisë greke, ndërkohë që zhvillonin një koncept të ri nacionalizmi. Greqishtfolësit që udhëtonin dhe jetonin në Europë – tregtarë dhe studentë – nisën të përthithin këto ide. Filo- helenët ndihmuan për të ushqyer një lëvizje drejt pavarësisë së Greqisë, që rezultoi në revolucionin e vitit 1820 dhe që e çliroi më në fund Greqinë nga sundimi otoman. Disa europiano-perëndimorë, ndër më të spikaturit prej tyre, poeti anglez Lordi Bajron, shkuan për të luftuar për këtë kauzë.

Revolucioni funksionoi, dhe e pati kulmin tek njohja ndërkombëtarisht e një shteti të ri grek në vitin 1832. Ai “mbolli” gjithashtu helenizmin si mitin themelues të kombit, duke i riorientuar greqisht-folësit drejt një identiteti kombëtar, i cili kishte në qendër lavdinë e lashtësisë. Pothuajse menjëherë, nisën të shfaqen probleme.

“Europianët kishin disa ide të ekzaltuara – “Do shkojmë të takojmë Agamemnonin dhe Perikliun” – dhe ata ishin të zhgënjyer nga grekët”, thotë Greene. “Ka Europë dhe Europë, dhe kjo nuk ishte Europa e duhur”.

Kjo bëri që grekët e vërtetë të shkëputeshin prej vetë qeverisë së tyre. Nuk do të kishte një rikthim të menjëhershëm tek demokracia e Athinës. Teksa Greqia e pavarur e sapolindur ishte zhytur në kaos, fuqitë europiane u mblodhën në Londër dhe emëruan një Mbret – Otto, një princ bavarez i transplantuar – si dhe i vunë kufi ushtrisë greke.

“Në të gjithë Ballkanin, por sidomos në Greqi, një shtet që ka gjithmonë mbi vete barrën e të mos qenurit në gjendje të arrijë nivelet e Greqisë së lashtë, ka një marrëdhënie të dyfishtë kundrejt Europës”, thotë Greene. “Fuqitë e Mëdha ishin jetike për sigurimin e pavarësisë nga ana e Greqisë, dhe në të njëjtën kohë, nxituan të bëjnë të qartë se Greqia nuk do të ishte një shtet europian, në të njëjtin nivel”.

Historia e mospagimit të borxheve nga ana e shtetit grek është e lidhur ngushtë me këtë marrëdhënie të trazuar me Europën. Siç e kanë bërë të qartë disa komentatorë, vendi ka qenë në këtë gjendje mospagimi për pothuajse gjysmën e ekzistencës së tij si shtet i pavarur. Në fakt modeli është më i ndërlikuar, se sa thjeshtë një dështim i përsëritur i pagimit të borxheve. Është një rreth vicioz që përsëritet, me marrëzinë e huadhëniesve nga ana e kredidhënësve europianë dhe keqmenaxhimin e grekëve, dhe që i ka rrënjët 200 vite pas në kohë. Shkelja e parë e afateve të pagimit ka ndodhur gjatë luftës për pavarësi, kur rebelët nuk mund të shlyenin huatë e europianëve, që ua kishin dhënë për të luftuar. Fuqitë e Mëdha dhanë më shumë hua në vitin 1832, kur u vendos Mbreti Otto; në vitin 1843, një grusht shteti vendosi limite kushtetuese ndaj tij, dhe Greqia nuk pagoi sërish borxhet. Gjatë Luftës së Krimesë në vitet 1850, grekët u përpoqën të bëjnë aleancë me rusët, duke i parë ata si një aleat më të qëndrueshëm se sa Britania dhe Franca (është një paralele historike me vardisjen e Athinës ndaj Moskës gjatë javëve të fundit). Basti dështoi dhe anijet europiano perëndimore pushtuan portet greke. Greene, e cila aktualisht jep leksione në Selanik, thotë se ka parë në rrjetet sociale kohët e fundit, karikatura të epokës së luftës së Krimesë, në të cilat shfaqet Britania që tërheq për veshi Greqinë.

Në fundin e viteve 1870, Greqia pagoi borxhet sovranë dhe nisi të ketë sërish akses në tregjet e huaj. Ajo mori hua me tepri dhe shkeli dhe një herë afatet e pagesave në 1893. Kredidhënësit e huaj krijuan pas kësaj, një “komitet Ndërkom-

bëtar për Menaxhimin e Borxhit Grek” për të imponuar reforma dhe mbikëqyrur borxhin grek.

Kjo marrëdhënie mes huamarrësve grekë dhe huadhënësve europianë mund të duket si një simbiozë toksike, por secila palë ka gjetur një fajtor alternativ në perandorinë otomane. Tekstet grekë ia vënë fajin turqve të urryer, që shtypën nacionalizmin dhe arsimin grek, një pretendim që është anakronik – nacionalizmi është një shpikje relativisht e re – dhe i pavërtetë, sipas ekspertëve të historisë otomane, me të cilët kam folur. “Nëse otomanët ua bënë këtë gjë grekëve, dhe qenka kaq keq, atëherë përse nuk e kanë përmbysur tendencën, që kur shpallën pavarësinë?”, më tha Carter Findley, një profesor i spikatur i historisë në Ohio State University. “kanë patur 185 vjet për të zgjidhur problemet e tyre, dhe nuk e kanë bërë”.

Shumë gazetarë, për shembull, kanë përsëritur një pretendim se shmangia e taksave ishte një gjest patriotik në Greqinë otomane, një mënyrë për t’i rezistuar autoritetit të Stambollit. Është e vërtetë që paaftësia për të vënë në zbatim ligjet e taksave ka ulur shumë të ardhurat e qeverisë greke, por historianët otomanë e shohin me dyshim këtë pretendim. Qeveritë e vona otomane mbështeteshin tek një sistem taksimi, sipas të cilit një taksambledhës lokal do i paguante paraprakisht një tarifë Sulltanit, në këmbim të të drejtës për të mbledhur taksat në zonë. Një sistem i tillë mund të nxisë pangopësinë në taksim, dhe mund të krijojë një rezistencë ndaj taksave, por është e vështirë që të gjithë fajin t’ia hedhësh sulltanit.

Një pengesë ndaj një taksimi më efikas është se Greqia nuk ka regjistër tokash. Jean Claude Junckeri, presidenti i Komisionit Europian, ia ka vënë fajin otomanëve edhe për këtë, por territore të tjerë otomanë kanë patur regjistër tokash; në fakt, ndërtesa e vjetër e regjistrit qendror të tokave është ende në këmbë në Stamboll.

Kjo mënyrë e qortimit të otomanëve ka një qëllim të dyfishtë për Europën Perëndimore: Ajo largon fajin nga roli i Europës në falimentin e Greqisë,

dhe në mënyrë retorike e shtyn Greqinë drejt periferisë së Europës, sikur historia e Greqisë si pjesë e Lindjes Islamike hedh në erë pretendimin e këtij vendi për anëtarësim të plotë në komunitetin europian. Nuk është një taktikë e re, as SHBA nuk kanë qenë immune ndaj konsiderimit të popujve të Ballkanit, ku Greqia bën pjesë, si krijesa emocioni dhe jo arsyeje, ndoshta jo të aftë të merren vetë me punët e tyre. Në një ese të botuar në vitin 1993 tek New York Review of books, George Kenan, plaku i mençur i diplomacisë amerikane, shkruante se shumë pak gjëra kanë ndryshuar në periudhën mes luftërave Ballkanike të viteve 1910 dhe atyre të tashme, dhe se “asnjë vend i veçantë apo grup vendesh” nuk mund të mposhtë “popujt e eksituar” të rajonit të Ballkanit, apo “të vërë rregull mes tyre, deri sa të qetësohen dhe t’i shohin në një mënyrë më të rregullt e të qetë proble-

Kjo mënyrë e qortimit të otomanëve ka një qëllim të dyfishtë për Europën Perëndimore: Ajo largon fajin nga roli i Europës në falimentin e Greqisë, dhe në mënyrë retorike e shtyn Greqinë drejt periferisë së Europës, sikur historia e Greqisë si pjesë e Lindjes Islamike hedh në erë pretendimin e këtij vendi për anëtarësim të plotë në komunitetin europian. Nuk është një taktikë e re, as SHBA nuk kanë qenë immune ndaj konsiderimit të popujve të Ballkanit, ku Greqia bën pjesë, si krijesa emocioni dhe jo arsyeje, ndoshta jo të aftë të merren vetë me punët e tyre

met e tyre”.

Vazhdimësinë e stereotipeve të tillë mund ta shohim në debatin e sotëm mbi Greqinë. Shumë grekë protestojnë se padrejtësisht paraqiten si dembelë dhe të pangopur, sidomos në mediat gjermane, ku kërkesat e grekëve për çlirim nga borxhet janë përcjellë me neveri. Sondazhet kanë treguar se, ndërkohë që pothuajse të gjithë europianët besojnë që gjermanët janë më punëtorët dhe më pak të korruptuarit në BE, shumica e tyre mendojnë që grekët janë më dembelët, një lloj përshtypjeje e cila – e vërtetë ose jo – mund të ndikojë tek negociatorët europianë që janë në diskutime me Greqinë. Gjermanët ndonjëherë protestojnë se grekët ndajnë të njëjtët stereotipe, por janë sërish sondazhet që tregojnë se grekët mendojnë për veten e tyre, se janë më punëtorët. (Duhet pranuar se ata mendojnë gjithashtu që janë rrezikshëm të korruptuar). në dritën e historisë, Greene e ka parë referendumin e të dielës, ku votuesit grekë hodhën poshtë paketën e shpëtimtimit të ofruar nga kredidhënësit, pjesërisht si shprehje e anktheve të votuesve grekë për vendin e tyre në Europë.

“Ata që votuan PO investojnë në idenë e qëndrimit në Europë”, thotë ajo. “Në Greqi, për një kohë të gjatë ka dominuar një ndjesi se, ‘ne e kemi humbur trenin, kemi qenë nën sundimin mysliman dhe kjo na pengoi që të jemi europianë. Më në fund po pranohe mi në klubin europian dhe duhet të qëndrojmë në Europë””. Por më shumë se 60% e votuesve shprehën të njëjtën pakënaqësi kundër hegjemonëve europiano perëndimorë, ashtu si kanë bërë paraardhësit e tyre në vitet 1832, 1843 dhe 1854. “Ata që votuan JO, kanë menduar: po na tërheqin sërish për hunde europiano perëndimorët, sikur ne të mos jemi vetë europianë”, përmbyll Greene.

The Atlantic



Akti final në Europë. Tetë burra dhe dy gra vendosin fatet e Greqisë

Në komedinë e artit, maskat janë pak a shumë gjithmonë të njëjtat. Por recitojnë sipas temës, mbi bazën e një kanavace të thjeshtë. Dhe ndërkohë që ndonjë maskë është gjithmonë e njëjtë me vetveten, të tjerat marrin role që ndryshojnë: ndonjëherë të mirë, ndonjëherë të këqinj, ndonjëherë të pakompromis, ndonjëherë pajtues. Protagonistët europianë të kësaj telenovele greke, që nuk ka fund, nuk bëjnë përjashtim. Janë ata që janë reshtuar një herë e mirë në frontin e fajkonjve, apo në atë të pëllumbave. Dhe të tjerë që recitojnë sipas rastit, duke u përshtatur me situatat dhe nevojat e kanavacës. Rregullat e komedisë së artit parashikojnë dhjetë personazhe: tetë burra dhe dy gra. Ja cilët janë.

François Hollande

Në çështjen greke, presidenti socialist francez, ka qenë kreu më koherent dhe i palëkundur i pëllumbave. I vetmi që në gjithë këta muaj ia ka dalë të mos shfaqë asnjëherë, as edhe shenjën më të vogël të irritimit me Tsiprasin. Trashëgimtar i denjë i Giscard, i cili e donte me çdokusht Greqinë në BE, dhe i Chirac, që shtroi rrugën e hyrjes së Athinës në Eurozonë. Si një francez i mirë, i jep euros një vlerë shumë të fortë si simbol angazhimi për ndërtimin europian. Për këtë arsye, monedha e përbashkët është e tillë vetëm nëse mbetet e pandarë, dhe nuk mund të lejojë që të humbasë copa rrugës. Përtej kësaj, si një socialist i vërtetë, refuzon që të pranojë që konsiderata të pastra kontabiliteti, të bien ndesh me bindjet e tij

më të thella politike.

Wolfgang Schaeuble

Është alter egoja e Hollande: pika e referimit ideologjike e fajkonjve. Ministri gjerman i Financave, një eksponent historik i CDU-së, është një mbështetës i bindur i një monetarizmi darvinian, që e sheh euron si një instrument për të shtyrë përpara evolucionin e politikës europiane, drejt majave gjithnjë e më të larta të efikasitetit dhe konkurrueshmërisë. Ashtu si pothuajse të gjithë gjermanët, ka një koncept “etik” për monedhën e përbashkët: frut i vlerave të përbashkëta dhe të skalitura në traktate. Prej vitesh Schaeuble uron një dalje të Greqisë nga euro. Një politikan shumë i aftë, di të shfaqet pajtues atëherë kur duhet. Por mbetet i bindur që, në fund, do të jetë ai që do ta fitojë ndeshjen në lidhje me Grexit.

Jean Claude Juncker

Babai i zhgënjyer. Dishepull dhe nxënës i Helmut Kohlit, presidenti i Komisionit ka fituar zgjedhjet europiane duke paraqitur një fytyrë të PPE-së, më të ndjeshme ndaj problemeve sociale dhe padrejtësive të politikave të kursimit. E ka pritur Tsiprasin si një djalë: përkëdheli, shaka, fërkim shpatullash. Në gjithë këta muaj është përpjekur të gjejë pika kompromisi më të favorshme ndaj kërkesave greke. Tsiprasi i hodhi në erë tratativat dhe thirri një referendum kundër propozimeve të tij. Juncker u ndie i tradhëtuar. Ka përdorur fjalë të ashpra ndaj Athinës. Por vazhdon të përpiqet të gjejë një marrëveshje.

Matteo Renzi

Mes gjithë maskave të kësaj komedie, është ajo më shumë në vështirësi. Jo vetëm sepse është në krye të vendit që ka borxhin më të madh publik, pas Greqisë, dhe si pasojë mbetet i brishtë, pavarësisht garancive të tij për të kundërtën. Edhe në fushën politike është në vështirësi. Ndan shumë ide të Tsiprasit, mbi nevojën e një mirëkuptimi europian, por nuk miraton as metodat dhe as objektivat. Ndan metodat dhe objektivat e Merkelit, por nuk i pëlqen ngurtësia gjermane. Fajkua, kur deklarons e “referendumi është një zgjedhje mes dhrahmisë dhe Euros”.

Pëllumb kur, ashtu si dje, siguron se “një marrëveshje është shumë pranë”. Tsiprasi i ka kërkuar disa herë që të ndërmeret. Ai e ka bërë, por prapa kuintave. Ia ka lënë Hollande udhëheqjen e pëllumbave. E pamundur t’i japësh të drejtë.

Angela Merkel

Me dy maska. Pëllumbeshë nga karakteri: kërkon gjithmonë marrëveshjen dhe kompromisin. Fajkua për nga kultura: privatisht mbështet vizionin etik dhe darvinian të Schaeubles. Pëllumbeshë për nga detyra: si udhëheqëse europiane, ka përgjegjësinë që të shmangë përçarje dramatike mes shteteve anëtarë. Fajkua për nga interesat: zgjedhësit e saj dhe opinioni publik janë kundër një pakete tjetër shpëtimi për Greqinë. Edhe ajo reciton sipas temës. Por duke bërë kështu, shkruan Historinë.

Christine Lagarde

Gjykatësja e rreptë. “Duhet njerëz të rritur në tryezë”, thotë drejtoresha e Fondit Monetar Ndërkombëtar, për të kritikuar veprimet foshnjarakë të Varoufakisit. Thumbuese kur tregon me gisht papërshtatshmërinë dhe pamjaftueshmërinë e propozimeve greke. Pajtuese, kur thyen tabutë europiane, për të kërkuar një ristrukturim të borxhit të Athinës. Duket se i bindet një logjike ekonomike të hekurt, por sillet mirë dhe me joeuropianët, që i duhen për ta rizgjedhur në krye të FMN. Ndërkohë, deri tani, është e vetmja që nuk i ka marrë paratë që i ka dhënë hua Tsiprasit.

Pierre Moscovici

Pëllumbi i fundit. Socialist dhe francez si Hollande, i emëruar Komisioner i Çështjeve Ekonomike me dëshirën e presidentit francez. Në Bruksel është mbështetës i pozicioneve më pajtues. Besnik i linjës së Parisit.

Jeroen Dijsselboem

Fajkua hezitues. Presidenti i Eurogrupit është socialist, por holandez: nuk është

një oksimaron, por i ngjan. I majtë, por supermbshtetës i rreptësisë fiskale. E urrente Varoufakisin. Nuk u beson grekëve. Me zemër do i donte jashtë Euros, ashtu si Schaeuble. Por duhet të ndjekë orientimet që mbizotrëojnë mes grupit të ministrave që kryeson. Edhe sepse, edhe ai, është në kërkim të rikonfirmimit në postin që mban.

Mariano Rajoy

Fajkoi i konvertuar. Kryeministri spanjoll mund të kish qenë fare mirë edhe një pëllumb, i ndjeshëm ndaj sakrificave që u imponuan prej rreptësisë së gjermanëve. Por pasi ato sakrifica, iu desh t'ua imponojë edhe zgjedhësve të tij për të shpëtuar Spanjën, është bërë një mbrojtës i papërkulur i rreptësisë fiskale. Në krye të të konvertuarve me forcë, që përfshijnë portugezët, spanjollët, letonezët dhe sllovenët.

Mario Draghi

Eshtë deus ex machina. Presidenti i Bankës Qendrore Europiane, nuk është as me fajkonjtë dhe as me pëllumbat. Eshhtë mbi të gjithë. Jo vetëm prej rolit institucional, por edhe sepse, prej kohësh, fluturon shumë më lart se të gjithë udhëheqësit e tjerë europianë. Në fund, do të jetë ai që do të shpëtojë Athinën, apo do ta shtyjë jashtë Euros. Por, të paktën këtë herë, vendimi do u përkasë politikanëve.

La Repubblica – Bota.al



Fatkeqësitë e shumëfishta ekonomike të Evropës

NGA PAUL KRUGMAN

Është dëshpëruese të mendosh në lidhje me Greqinë këto ditë, kështu që le të flasim për diçka tjetër, në rregull? Le të flasim, si fillim për Finlandën, e cila nuk mund të jetë më e ndryshme, nga vendet e korruptuara dhe të papërgjegjshme të jugut të Evropës.

Finlanda është model i qytetarisë evropiane; ajo ka një qeveri të ndershme, financa të shëndosha dhe një vlerësim të fortë mbi kreditimin, e cila i lejon të marrë hua me norma interesi tepër të ulëta. Ky vend, ndodhet ndërkaq në vitin e tetë të një rënieje ekonomike, e cila e ka reduktuar prodhimin e brendshëm bruto me 10 përqind dhe që nuk po tregon shenja ndaljeje.

Në fakt, po të mos ishte për makthin në Evropën jugore, problemet me të cilat përballlet ekonomia finlandeze, mund të shiheshin edhe si një fatkeqësi epike. Dhe Finlanda nuk është e vetme në këto ujëra të turbullta. Ajo është pjesë e një blloku ekonomish në rënie, që shtrihen në të gjithë Evropën veriore duke filluar nga Danimarka - e cila nuk është anëtare e Eurozonës, por i ka menaxhuar financiat e saj sikur të ishte - deri në Holandë.

Të gjitha këto vende janë duke bërë shumë më keq se Franca, ekonomia e së cilës ndodhet në presionin e tmerrshëm të gazetarëve, që e urrejnë rrjetën e saj të fortë

të sigurisë sociale, por ajo është mbajtur në fakt më mirë, se thuajse çdo komb tjetër evropian, përveç Gjermanisë.

Por për Evropën Jugore jashtë Greqisë, ç'mund të themi? Zyrtarët evropianë e kanë hiperbolizuar rimëkëmbjen ekonomike të Spanjës, e cila bëri gjithçka që duhej të bënte dhe ekonomia e të cilës më në fund ka filluar të rritet përsëri, dhe madje edhe krijuar vende të reja pune.

Por sukses, sipas stilit evropian, do të thotë një normë papunësie që është ende gati 23 përqind, dhe ku të ardhurat reale për frymë janë 7 përqind më poshtë nga niveli i saj para krizës. Portugalia gjithashtu, ka zbatuar me bindje masat e ashpra të kursimit - dhe është aktualisht 6 përqind më e varfër, sesa duhej të ishte. Po përse ka kaq shumë fatkeqësi ekonomike në Evropë?

Aktualisht, ajo që të bën përshtypje në këtë pike, është sesa ndryshojnë historitë e origjinës së krizave evropiane. Po, qeveria greke ka marrë borxhe me tepri. Nga ana tjetër qeveria spanjolle, nuk e ka bërë këtë. Përkundrazi, kriza e Spanjës lidhet e gjitha me kreditimin privat dhe spekulimet në sektorin e strehimit. Edhe historia e Finlandës, nuk ka dhe aq të bëjë me borxhet. Ajo lidhet me kërkesën e dobët për produkte pyjore, që mbetet ende një eksport i madh kombëtar, si dhe me pengesat që has prodhimi finlandez, në veçanti kampioni i dikurs-hëm kombëtar i saj, Nokia.

Megjithatë, ajo që të gjitha këto ekonomi kanë të përbashkët, është se duke u bashkuar me eurozonën, ato e vendosin veten nën një "këmishë force" ekonomike. Finlanda ka përjetuar një krizë shumë të rëndë ekonomike në fund të viteve '80 - shumë më keq, në fillim, sesa ajo që po ndodh tani. Por ajo ishte në gjendje ta rrimerrte shpejt veten, kryesisht falë një zhvlerësimi të fortë të monedhës së vet kombëtare, duke i bërë eksportet e saj më konkurruese. Këtë herë, për fat të keq, nuk ka monedhë për t'u zhvlerësuar.

E njëjta vlen edhe për vatrat e krizës, në zonat e tjera të Evropës. A mos do të thotë kjo se krijimi i Euros ishte një gabim? E pra, po. Por kjo nuk është njëllë si të thuash, se duhet të eliminohet tani që ajo ekziston. Urgjente për momentin, është të çlirohet nga këmisha e forcës.

Kjo do të përfshinte veprime në fronte të shumta, nga një sistemi i unifikuar i garancive bankare, tek një gatishmëri për të ofruar lehtësimin e borxheve, për vendet ku borxhi është problemi. Ajo gjithashtu duhet të përfshijë krijimin e një mjedisi të përgjithshëm më të favorshëm, për vendet që përpiqen të rregullojnë fatin e keq duke e braktisur kursimin e tepruar, dhe bërë çdo gjë që është e mundur për të rritur normën themelore të inflacionit në Evropë - aktualisht nën 1 përqind - të paktën deri në objektivin zyrtar prej 2 përqind.

Por ka shumë zyrtarë evropianë dhe politikanë, të cilët i kundërvihen çdo gjëje që mund ta bëjë euron më funksionale, dhe të cilët besojnë ende se gjithçka do të jetë mirë, nëse të gjithë i nënshtrohen një disipline të mjaftueshme. Dhe kjo është arsyeja pse ka edhe shumëçka në rrezik në referendumin grek të së dielës,

Një nga rreziqet e mëdha, nëse vota e qytetarëve grekë është në shumicë po - që është pranimi i kërkesave të kreditorëve, duke hedhur kështu poshtë qëndrimin e qeverisë greke dhe ndoshta e rrëzuar atë - është se ai verdikt do të fuqizojë dhe inkurajojë arkitektët e dështimit Evropian. Kreditorët do të dëshmojnë forcën, aftësinë e tyre për të poshtëruar cilindo, që sfidon kërkesën për masa kursimi pa fund. Dhe ata do të vazhdojnë të pretendojnë, se imponimi i papunësisë masive është i vetmi kurs i përgjegjshëm veprimi.

të cilën shumica e vëzhguesve e kuptojnë.

Një nga rreziqet e mëdha, nëse vota e qytetarëve grekë është në shumicë po - që është pranimi i kërkesave të kreditorëve, duke hedhur kështu poshtë qëndrimin e qeverisë greke dhe ndoshta e rrëzuar atë - është se ai verdikt do të fuqizojë dhe inkurajojë arkitektët e dështimit Evropian. Kreditorët do të dëshmojnë forcën, aftësinë e tyre për të poshtëruar cilindo, që sfidon kërkesën për masa kursimi pa fund. Dhe ata do të vazhdojnë të pretendojnë, se imponimi i papunësisë masive është i vetmi kurs i përgjegjshëm veprimi.

Çfarë ndodh nëse Greqia voton kundër? Kjo do të çojë në një terren të frikshëm e të panjohur. Athina mund edhe të largohet nga euro, akt që do të jetë jashtëzakonisht përçarës në një periudhë afatshkurtër. Por ajo gjithashtu do t'i ofrojë vetë Greqisë, shansin për një rimëkëmbje të vërtetë.

Dhe kjo do të shërbejë si një goditje e dobishme, ndaj vetëkënaqësisë të elitave të Evropës. Ose për ta thënë ndryshe, është e arsyeshme të kesh frikë nga pasojat e një "jo"-je, pasi askush nuk e di se çfarë do të ndodhë më pas.

Por duhet të kihet edhe më tepër frikë nga pasojat e një "po"-je, sepse në këtë rast ne e dimë se çfarë vjen më pas - më shumë masa kursimi, fatkeqësi dhe përfundimisht një krizë shumë më e keqe, se çdo gjë tjetër që kemi parë deri më tani.

"The New York Times"



“Mësymbja e madhe”: Të gjithë drejt Kubës!

A mos është efekti Obama që ka filluar të ndihet? Qeveria kubane ka njoftuar çeljen e 35 pikave të reja Wi-Fi, lidhjeve publike të internetit, që shumë shpejt do të shkojnë në 150. Është një hapje e rëndësishme, në një vend ku aksesit ndaj internetit deri më tani, ka qenë një privilegj i elitave: e gëzon vetëm 5 përqind e popullsisë, shumica të pasur dhe pjesëtarë të nomenklaturës.

Zgjerimi i aksesit në internet, i bashkangjitet shenjave të tjera të liberalizimit politik, të regjistruara tashmë që pas 17 dhjetorit të shkuar, kur Barak Obama njoftoi për herë të parë kursin e ri amerikan: do të liroheshin 5 përqind e të burgosurve politikë (vitin e kaluar pati 9 mijë arrestime afat-shkurtra, duke përfshirë edhe disidentë).

Pas njoftimit historik të presidentit amerikan, mbi rilidhjen e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve, dhe emërimin e ambasadorëve përkatës, “rënia e Murit të fundit” të Luftës së Ftohtë krijon eksitim. Dhe kjo është me dukshme në sjelljen e të huajve: nga turistët e thjeshtë tek investitorët e mundshëm.

“Të gjithë në Kubë!”, është slogani i momentit. Amerikanët - të cilëve zyrtarisht ende nuk u lejohet të udhëtojnë në këtë ishull - dynden tek ato pak fluturime të “Air Canada” nëpërmjet Torontos (të rehatshëm, por me vonesa të tmerrshme), vetëm e vetëm për të vizituar Havanën “para se të jetë shumë vonë”. Domethënë para se moderniteti, globalizmi dhe biznesi të prishin muzeun e fundit të një bote që ishte: kjo relike e mahnitshme në vitet '50, që është Havana, me Kadi-

llakët kabriole të epokës së Hamfri Bogartit, baret e vjetra, ku Ernest Heminguej dhe Ava Gardner konsumonin dakuiri dhe mohito, fantazmat e muzikantëve të mëdhenj si Ibrahim Ferrer i Klubit Social “Buena Vista”, fasadat e vjetëruara të ndërtesave koloniale spanjolle të viteve ‘600 apo të fillimit të shekullit XX-të, godinat me arkitekturën e mrrekullueshme të lirisë, që amortizohen nën lagështinë tropikale.

Eksitimi ka shkaktuar rezervime të plota në hotele edhe në sezonin e vogël: në korrik këtu bën shumë e nxehtë dhe lagështi, hotelierët nuk kishin parë kurrë një fluks të tillë turistësh; marrin me qera edhe shtëpi private apo edhe dhoma të veçanta Kanë ardhur këtu edhe sipërmarrës italianë, për të mos ia rrëmbyer të tjerët “vendin e fundit komunist që hapet ndaj kapitalit” (ndoshta).

Ambasadori italian po përballet me një problem të pazakontë: shumë sipërmarrës kanë mësyre në Kubë. Javën e ardhshme vjen këtu një delegacion i udhëhequr nga zëvendësministri i Ekonomisë Karlo Kalenda dhe nënsekretari Mario Xhiro. Në fillim ishin regjistruar 100 pjesëmarrës, tanimë janë bërë 150, mes biznesmenëve, menaxherëve, përfaqësues bankash dhe shoqatash tregtare. Duhet sistemuar në një qytet, ku ka pak hotele me pesë yje, dhe që tashmë janë tejet të mbushur. SACE, e cila siguron kompanitë tona eksportuese, vlerëson se “eksportet italiane mund të arrijnë në 220 milionë euro brenda vitit 2019”. Një parashikim ky, që SACE i shton një kusht jo të qartë: “nëse realizohet planim i reformave”. Dhe fjalia e dytë, është çelësi për të kuptuar mosbesimin e shumë kubanezëve. Ata mbajnë mend edhe 3 hapje të rreme në të shkuarën: në veçanti atë të fillimit të viteve ‘90, kur rënia e Murit të Berlinit, shembja e Bashkimit Sovjetik dhe për pasojë fundi i ndihmave që Moska dërgonte në Kubë, u pasua nga njoftim i parë për reforma ekonomike, një tranzicion i supozuar drejt tregut të lirë, që në fakt nuk u realizua.

Më së afërmi, gjithnjë nën presionin e jashtëzakonshëm ekonomik, kur edhe Venezuela e zhytur në krizë ndërpreu ndihmat e saj, diçka lëvizti: veçanërisht në turizëm, një sektor ku komandojnë ushtarakët, të cilët në mënyrë paradoksale, janë krahu më modern i regjimit të Kastros.

Këto ditë në Havanë ndodhen drejtuesit kryesorë të gjigantit italian dhe botëror të kroçerave, MSC. Duke shfrytëzuar mangësitë e konkurrenteve të saj amerikane si “Carnival” dhe “Royal Caribbean” - embargoja tregtare e SHBA është ende në fuqi dhe Obama s’mund ta heqë atë pa pëlqimin e Kongresit - italia MSC, do të jetë e para që do të ofrojë udhëtime me kroçerë që nisen nga Havana, në fillim të dhjetorit.

Kjo është një fitore e çmuar, në një biznes turistik, ku deri më tani më të shkathtëta ishin kompanitë spanjolle, me rrjetin e tyre të madh hotelier “Melia”. Se çfarë lloj ekonomie do të ketë Kuba pas 5, 10 apo 20 viteve, kjo është një pyetje që askush nuk mund t’i përgjigjet. As presidenti Raul Kastro, i cili në moshën 83-vjeçare, mund të shpresojë vetëm të udhëheqë hapat e para të kursit të ri.

Gati 60 vjet pas revolucionit komunist të vitit 1959, dhe pas 54 vitesh embargo nga SHBA, nuk ka modele të së kaluarës për t’iu referuar. Në epokën e para-revolucionit nën diktatorit Batista, Kuba ishte shndërruar në një bordello të Amerikës, me kazinotë e saj dhe prostitucionin në duart e bosëve të mafias si Al Kapone, Laki Luçiano, Sem Xhiankana. Socializmi i spastroi ato fenomene, edhe pse sot dikush ka frikë se mbeturinat e mafiozëve mes kubano-amerikanëve në Miami, mund të zgjasin tentakulat e tyre drejt ishullit, duke rifilluar një biznes siç është ai i prostitucionit, që ka tashmë ka filluar të lulëzojë prej disa vitesh, në një mënyrë “artizanale”, me turizmin seksual.

Socializmi kastrist e praktikoi ekonominë e luftës me të gjitha shtrembërimet e saj: racionimin e ushqimit, regjimin e dyfishtë të monedhës me pezos që blejnë pak, dhe ta lakmuarat Cuc (njësi e monedhës kubane), e rezervuar për ata që kryejnë transaksione me të huajt.

Katastrofa në bujqësi - ky ishull pjellor dhe i shëndetshëm, është i detyruar të importojë 80 përqind të nevojave ushqimore - ka reduktuar ndërkaq edhe efektet e dobishme të turizmit, sepse hotelet e mëdha dhe fshatrat turistike duhet t'i blejnë jashtë vendit mishin dhe peshkun e ngrirë.

Është ajo që kubanët me hidhërim e quajnë “embargoja jonë e brendshme”: ekonomia private mbetet e vogël, punëson gjysmë milioni njerëz nga 11 milionë banorë që ka ishulli. Ka shumë pak zanate, që përdoren për përfitime private si restorante, taksi, mekanikë, kooperativa të vogla ndërtimi. Çdo gjë tjetër, është në duart e një shtet pushtues, një nomenklaturë të ndërmjetme, e cila deri tani ka bllokuar përpjekjet e pakta për rinovim, të njoftuara nga “familja mbretërore” (kështu quhen Fidel, Raul Kastro dhe të afërmit).

“Të paktën, ne nuk jemi Brazili” - thotë me krenari një balerinë e njohur, e martuar me një biznesmen. Ajo thotë se ka shumë pak kriminalitet: një sukses i pamohueshëm i socializimit, që e bën Kubën një oaz sigurie në Karaibe, dhe në të gjithë Amerikën Latine. Vendin e dallon edhe “socializmi mjekësor”, shëndetësia pararojë që eksporton mjekët, për të reduktuar borxhin publik prej 26 miliardë dollarësh (nga të cilat 8 miliardë në mungesë). Mbi 30 mijë mjekë kubanë punojnë në Venezuelë, 12 mijë të tjerë mes Brazilit dhe vende të tjera amerikano-latine, 12 mijë në Afrikë: burimi kryesor i valutës së huaj. Në këtë aspekt, shprehet se mund të nxitet një biznes i ri botëror, duke e shndërruar Kubën në një platformë për kërkim bio-mjekësor, për shumëkombëshet e Big Pharma.

Më të guximshmit në mesin e reformatorëve të regjimit, shikojnë nga modeli i Izraelit, ideja për ta kthyer një komb të tërë drejt një fillimi të ri. Mjafton të dalësh nga Havana, të shëtisësh një fshat të varfër dhe arkaik, për të kuptuar hendekun e madh, që ekziston midis këtyre sloganeve dhe realitetit.

La Repubblica



Njëzetë vjet më vonë: Plagë të gjalla dhe varre të hapura

NGA MICK KREVER

Ramo Ademoviç nuk e mban mend se si i mbijetoi gjenocidit të Srebrenicës. 20 vjet më parë, në 11 korrik 1995, ai hyri në të ashtuquajturin “shtegun e vdekjes” - i prirë nga trupat serbo-boshnjake, të cilat vranë mijëra myslimanë brenda dhe përreth Srebrenicës. “Mbajta një ditë gjatë gjithë luftës”, thotë ai, duke qëndruar pranë varrit të vëllait.

Kur të dalë në pension, do të lexojë më në fund kujtimet që i ka bllokuar tërësisht, dhe do i hedhë në letër për brezat e ardhshëm.

Historia e tij është një prej një mijë të tillave, në këtë ditë kujtimi, dhe gjithësecila meriton një libër kujtimesh.

Përpara se të vizitosh këtë varrezë, nuk e kupton dot kurrë, se sa e çuditshme është që një mijë gurë varri, të kenë të skalitur të njëjtin vit vdekjeje, 1995-ën.

Njëzetë vjet më vonë, plagët janë ende të gjalla, dhe varret janë ende të hapur - në

kuptimin e vërtetë të kësaj fjale. Njëqind e 36 kuti me eshtra u varrosën këtu sot, siç ndodh me eshtrat e gjetura rishtaz, në çdo përvjetor të masakrës.

“Pas njëzetë vitesh, mpihesh krejt, nuk e di nëse je goditur prej dhimbjes apo lumturisë”, kur më në fund, arrin të varrosësh disa të vdekur”, thotë Ademoviç në gjuhën e tij.

Lumturia, shton ai, buron prej faktit që më në fund ke një vend ku të vish e të lutesh. “Por do të jetë gjithmonë një plagë e hapur”.

Se sa e hapur është ajo plagë, këtë e pa e gjithë bota në këtë ditë tmerrësisht të nxehtë. Kryeministri serb, Aleksander Vuçiç u detyrua të largohet mes panikut, i rrethuar prej truprojave me kostume të errët, pasi ata që vajtonin dhe pjesëmarrësit u acaruan dhe nisën ta godasin me gurë dhe me shishe, teksa ai përpiquej të çante mespërmes turmës.

“Takbir Allahu akbar!” - Zoti është i madh! - thërriste turma.

Myftiu i madh i Bosnjes, duke iu drejtua turmës, më vonë i qortoi për faktin që kishin sulmuar Kryeministrin serb.

Pjesëmarrja e Vuçiçit ishte menduar si një shtrirje dore dhe shprehje ngushëllimi. Por vetoje e vendosur nga Rusia javën e fundit, ndaj një rezolute të Këshillit të Sigurimit, që e quante atë që ka ndodhur këtu një “gjenocid”, ka rënduar shumë në Bosnje.

Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve në Ish Jugosllavi “ka vendosur përtej çdo dyshimi, se vrasja e 7000-8000 të burgosurve boshnjakë ishte gjenocid”.

Vendi mbetet shumë i ndarë etnikisiht. Boshnjakët myslimanë drejtojnë gishtin nga serbo-boshnjakët për faktin që nuk janë prmirësuar kurrë; serbo-boshnjakët thonë shpesh herë se edhe myslimanët kanë kryer krime gjatë luftës, e cila zgjati nga 1992 deri në 1995.

Vuçiç nuk ishte pjesëmarrësi i vetëm që shkaktoi polemika.

Presidenti Bill Clinton, i cili ishte në detyrë gjatë luftës, shihet me ndjenja të përziera. Ishte nisma e tij që solli fundin e luftës, me një ndërhyrje të NATO-s dhe bisedimet e paqes të ndërmjetësuar nga amerikanët, por ai gjithashtu bëri shumë pak për të ndaluar vrasjen e mijëra civilëve gjatë tre viteve të parë të luftës. Edhe pjesëmarrja e ministrit të jashtëm holandez, shkaktoi shumë debate.

Paqeruajtësit holandezë të armatosur lehtë, të vendosur në rrugën dalëse të Srebrenicës dhe që mbronin shumë myslimanë boshnjakë, nuk arritën të ndalin gjenocidin.

Një ish fabrikë baterish, e cila shërbente si bazë e holandezëve, tani qëndron e boshatisur përtej varrezës, si një dëshmi trazuese e tmerreve. Një gjykatë holandeze vendosi vitin që kaloi se vendi është përgjegjës për vdekjen e më shumë se 300 burrave, të cilët u morën nga baza holandeze dhe u vranë. Bert Koenders tha se qeveria e tij ndante përgjegjësinë për masakrën dhe ashtu si shumë folës të tjerë, e quajti gjenocid.

Për shumë prej të pranishmëve që vajtonin pranë varreve të njerëzve të dashur,

Dalëngadalë, teksa ata varre zbulohen, ADN e nxjerrë nga kockat është krahasuar me atë të të afërmve të viktimave. Shpesh herë, ajo që gjendet janë veç disa kocka. Nëse eshtrave të pjesshme u bëhet një varrim i denjë, kjo varet nga familjarët.

Ademoviç thotë se eshtrat e të vëllait u gjetën tre vjet më parë, por familja vetëm tani vendosi ta varrosë. Ata mund të rivarrosin gjithmonë eshtra të tjera, nëse gjenden, thotë ai. “Pas kaq shumë vitesh, kjo është e vetmja gjë që mund të të japë një ndjesi lehtësimi”, thotë ai

pjesëmarrja e udhëheqësve botërore, pak rëndësi kishte.

“Për mua nuk do të thotë asgjë”, thotë Hadzira Doziç. “Ajo që ka rëndësi është: dhimbja është brenda meje”.

Eshtrat e vëllait të saj, 32 vjeç në kohën e vdekjes në masakër, u gjetën në një varr masiv, bashkë me ato të të shoqit. “Nuk mund të bëhet asnjëherë. SI mund të bëhet?”

Ajo qëndronte ulur pranë varrit të hapur që priste eshtrat e të vëllait. Edhe burri i saj bashkë me tre vëllezërit e tij u vranë, ashtu si edhe 30 pjesëtarë të tjerë të familjes, thotë ajo. Nuk ishin vetëm të afërm, apo edhe vetëm boshnjakë, që udhëtuuan drejt Srebrenicës. Azra Mehonjiç, nga Mali i Zi, tha se ndien një solidaritet të fortë me ata që vajtonin.

“Kur i shoh të qajnë, dua të qaj. Nuk mendoj se ata që e bënë këtë, kanë shpirt apo zemër”. Teksa falja nisi të dëgjohet në të gjithë lufinën përmes altoparlantëve, mijëra burra dhe gra myslimanë u kthyen nga lindja dhe nisën të falen.

Në kodrat idilike të Bosnjes lindore, është e vështirë të imagjinosh tmerret që ndodhën këtu.

Srebrenica duhej të kish qenë një zonë e sigurtë e OKB, një enklavë myslimane në një territor të kontrolluar nga serbët etnikë. Por kur serbo- boshnjakët vendosën të marrin qytetin, banorët kishin shumë pak shpresë të largoheshin. Ata u qëlluan masivisht, trupat e tyre u hodhën, dhe më vonë u rivarrosën në varre masivë pr të fshehur provat.

Dalëngadalë, teksa ata varre zbulohen, ADN e nxjerrë nga kockat është krahasuar me atë të të afërmeve të viktimave. Shpesh herë, ajo që gjendet janë veç disa kocka. Nëse eshtrave të pjesshme u bëhet një varrim i denjë, kjo varet nga familjarët.

Ademoviç thotë se eshtrat e të vëllait u gjetën tre vjet më parë, por familja vetëm tani vendosi ta varrosë. Ata mund të rivarrosin gjithmonë eshtra të tjera, nëse gjenden, thotë ai. “Pas kaq shumë vitesh, kjo është e vetmja gjë që mund të të japë një ndjesi lehtësimi”, thotë ai.

CNN

Nga Tunizia në Libi, konfliktet e kryqëzuar që po djegin Mesdheun

Në Lindjen e Mesme sapo ka nisur një proces i gjatë, i destinuar të zgjasë shumë kohë. Shfaqen kombe të rinj; ribëhen kufijtë; përvijohet një Kurdistan që prej një kohe të gjatë ka qenë i ndarë në komunitete të nënshtruar; shkërmoqen shtete të cilët në format e tyre aktuale kanë lindur që në epokën koloniale, si Siria dhe Iraku; pritet me ankth dhe frikë, në zonat sunite, rikthimi i Iranit shiit si fuqi vendimtare në rajon, në rast të një marrëveshjeje për çështjen bërthamore, e si pasojë edhe një fundi të sanksioneve që e kanë dëmtuar prej kohësh; dhe një Iran i fortë krijon aleanca që një herë e një kohë ishin të pamendueshme, si për shembull ajo mes Arabisë Saudite dhe Izraelit. Shqetësimi për tërmetin politik që po ndodh në dyert tona ndikon padyshim, në këto orë, qasjen ndaj Greqisë, e shpërndarë me ishujt e saj nëpër Mesdhe, dhe një kufi i domosdoshëm për Europën

BERNARDO VALLI

Zona e Mesdheut është e mbushur me konflikte të ndërthurur mes tyre. Kishim përshtypjen që jetonim në një zonë e cila “nuk zinte rehat”, dhe tani, shpërthimet gjithnjë e më të shpeshtë të terrorizmit na bëjnë të ndihemi më pranë fushëbe-

tejtës. Dramës së refugjatëve i shtohet zjarri i luftërave, terrorizma që godasin Lindjen e Mesme, atje ku ndryshojnë kufijtë, dhe bëjnë xhiron nëpër vendet e bregut tjetër të esdheut, ku plagosin Tunizinë dhe mbështjellin Libinë. Këtyre konflikteve nuk u përvijohen lehtësisht kufijtë dhe nuk identifikohen armiqtë dhe miqë, sepse reshtimet ndryshojnë sipas vendeve ku ndodhin përplasjet. Nëse nuk e ekzaminon me lentën zmadhuese të ekspertit, dhe pa respektin e duhur për një tragjedi njerëzore, të krijohet përshtypja se në portat e Europës po ndodh një përzjerje vdekjeprurëse.

Në Lindjen e Mesme sapo ka nisur një proces i gjatë, i destinuar të zgjasë shumë kohë. Shfaqen kombe të rinj; ribëhen kufijtë; përvijohet një Kurdistan që prej një kohe të gjatë ka qenë i ndarë në komunitete të nënshtruar; shkërmoqen shtete të cilët në format e tyre aktuale kanë lindur që në epokën koloniale, si Siria dhe Iraku; pritët me ankth dhe frikë, në zonat sunite, rikthimi i Iranit shiit si fuqi vendimtare në rajon, në rast të një marrëveshjeje për çështjen bërthamore, e si pasojë edhe një fundi të sanksioneve që e kanë dëmtuar prej kohësh; dhe një Iran i fortë krijon aleanca që një herë e një kohë ishin të pamendueshme, si për shembull ajo mes Arabisë Saudite dhe Izraelit. Shqetësimi për tërmetin politik që po ndodh në dyert tona ndikon padyshim, në këto orë, qasjen ndaj Greqisë, e shpërndarë me ishujt e saj nëpër Mesdhe, dhe një kufi i domosdoshëm për Europën. Duke lënë mënjanë ekonominë. Ngjarjet që na ofron kronika e përditshme duhet që të analizohen, dora-dorës, pa nxitim. Është e mundur, për shembull, që atentati ndaj konsullatës italiane në Kairo është bërë për të frikësuar Italinë, ose Perëndimin në përgjithësi, siç kanë pohuar denoncimet e parë, të diktuar prej nxitimit, prej nevojës politike për të reaguar, por edhe pamjet e pallatit të vjetër, fisnik, ngjyrë okër, tashmë të dëmtuar, që na përfaqëson prej dekadash, në një lagje kryesore të kryeqytetit egjiptian. Duke u bazuar në versionin po aq të nxituar, i cili merr parasysh që eksplozivi është i njëjti me atë që është përdorur në 29 qershor për të vrarë Kryeprokurorin egjiptian, Hisham Barakat, objektivi i terroristëve mund të mos ketë qenë selia e konsullatës italiane, por një tjetër magjistrat, Ahmed al Fuddaly, që në atë orë ishte i pranishëm. Është një ushtrim i guximshëm, në situatën aktuale të Lindjes së Mesme, që të precizosh arsyet dhe të tregosh me gisht porositësit. Edhe ata që marrin menjëherë përsipër përgjegjësinë shkaktojnë dyshimë, sepse organizatat terroriste ndodh shpesh që të përvetësojnë aksione, të cilët në fakt janë kryer nga individë apo grupe të izoluar. Rëndësi kanë faktet. Në dy vitet e fundit, që kur marshalli Abdel Fatah Al Sisi dëboi nga pushteti Vëllazërinë Myslimane, të zgjedhur pas përmbytjes universale dhe më pas të paafte për të qeverisur, atentatet janë shumëfishuar në Egjipt. Represioni i ushtrisë ka shkaktuar mijëra të vdekur dhe ka rimbushur burgjet. Gjykatat kanë dhënë vendime me vdekje. Dhe nuk është rastësi që kryeprokurori u vra dy javë më parë. Edhe që dje është menduar se objektivi mund të mos ketë qenë konsullata italiane, por që viktima e vërtetë e projektuar nga terroristët të ketë qenë një gjykatës që ndodhej aty pranë. Një magjistrat që mendohet të jetë shumë afër marshallit Sisi, i zgjedhur president pas rrëzimit të Morsit, eksponentit të Vëllazërisë Myslimane.

Këta të fundit, përpara se të shpallehin jashtë ligjit me një dekret, përfaqësonin një vëllazëri me rrënjë të thella në popullin egjiptian. Ishte konkurrentja e vetme e shoqërisë ushtarake, e cila në brigjet e Nilit i ka rrënjët po kaq të thella. Ka forcat e armatosura, por kontrollon edhe një pjesë të madhe të ekonomisë.

Në mars ka patur atentate të tjerë kundër gjykatave që gjykojnë Vëllazërinë Myslimane. Dhe nuk kanë munguar shpërthimet në vende me shumë turizëm. Në Luxor u godit tempulli i Karnakut. Dhe dy ditë pas vrasjes së kryeprokurorit, në fillim të korrikut, ushtria egjiptiane ka pësuar sulme në Sinai. Pati të paktën tridhjetë të vdekur. “Kalifati”, ose “shteti islamik” që kontrollon një pjesë të madhe të Sirisë dhe Irakut, mendohet se nxit forcat rebele në gadishullin strategjik mes

Egjiptit dhe Izraelit.

Vrasja në Libi e punëtorëve egjiptianë të fesë kopte ka shkaktuar një reagim të kuptueshëm nga Egjipti, që disa muaj më parë ndërhyri me inkursione nga ajro dhe toka. Atje, në vendin fqinjë të pasur me naftë dhe fise që grinden mes tyre, shumë vëllezër myslimanë që në atdheun e tyre janë shpallur jashtë ligjit, kanë gjetur strehim dhe ndihmë. Dhe janë konvertuar lehtësisht në një Islam më radikal, më luftarak se sa ai që praktikohet nga vëllazëria egjiptiane. Terreni ishte dhe është i favorshëm për islamikët e shtypur në Kairo dhe që kanë dëshirë të hakmerren për shokët e vrarë apo burgosur. Pra, janë gati të praktikojnë një xhihadizëm të dhunshëm.

Libia është një tokë ku rivalitetet e vjetër mes fiseve marrin kollaj kthesa të dhunshme dhe pretekste fetarë. Gedafti e mbante nën fre vendin: pra, mos ka qenë gabim nxitja e fundit të tij? Koloneli libian po e humbiste në fakt kontrollin, kur perëndimorët ndërhyjnë në favor të rebelëve. Dhe zgjedhjet e para dhanë rezultate të arsyeshëm. Gabimi qëndroi në ndihmën e munguar për tranzicionin. Nga ai gabim e ka pësuar edhe Tunizia, fqinji lindor i Libisë, dhe që nuk është ndihmuar mjaftueshëm nga vendet perëndimorë gjatë kalimit të lodhshëm në demokraci. Për të shmangur “infektimin”, Tunizi ka në plan të ndërtojë një mur përgjatë gjithë kufirit. Ndonëse është i vetmi shtet që ka patur një vazhdimësi pozitive pas “pranverës arabe”, tashmë gjendet përballë një terrorizmi, të cilin përpiqet ta frenojë. Qeveria, e formuar nga liberalë dhe islamikë të moderuar, adopton masa sigurie të jashtëzakonshme. Qindra arrestime, xhami integraliste të mbyllura, ndalim riatdheshimesh për të rinj që dyshohet se i janë bashkuar kalifatit në luginën e Tigris dhe Eufratit. Konsiderohet një vend mitik dhe me një mençuri proverbiale, por Tunizia është vendi që ka ‘dhënë’ më shumë xhihadistë, pas Libisë.

CdS

Na vizitoni ne www.bota.al

bota.al

[Home](#) / [Ide](#) / [Ekonomi](#) / [Teknologji](#) / [Historia](#) / [Shkence](#) / [Kulture](#) / [Shendet](#) / [Sport](#)

Te fundit në bota.al

Njerëzit e gjykojnë personalitetin tuaj, duke u bazuar në këto 7 gjëra të vogla



KATALONJA / Histori e një rajoni rebel

ME TËRRE